

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6097  
E mërkurë, 26 gusht 2020  
çmimi 0.40 €

Edhe tetë të vdekur në  
24 orët e fundit nga  
Covidi në Kosovë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

BËHET THIRRJE PËR KONSENSUS NACIONAL PËR PROCESIN FINAL  
TË DIALOGUT ME SERBINË | FAQE 4-5

## BASHKËPUNIMI POZITË - OPOZITË FORCON POZICIONIN E KOSOVËS NË DIALOG ME SERBINË

Bashkëpunimi i pozitës me opozitën për dialogun me Serbinë do ta forconte pozicionin e Kosovës në këtë proces kanë bërë me dije udhëheqësit e koalicionit qeverisës dhe njohësit e rrethanave politike në vend. Ata kanë vlerësuar se nëse spektri politik do të bashkohej për këtë çështje, dialogu me Serbinë për njohje reciproke do të jetë më përmbajtësor dhe më i qëndrueshëm. Mirëpo opozita ka refuzuar qasjen e qeverisë ndaj dialogut me Serbinë. Lëvizja Vetëvendosje ka vlerësuar se ky proces do t'ia sjellë Kosovës "Zajednicën" ose shkëmbimin e territoreve me Serbinë



KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI KA VIZITUAR  
KOMUNËN E DEÇANIT

### HOTI: NË JAVËT E ARDHSHE GJENDET ZGJIDHJA PËR RRUGËN DEÇAN - PLAVË



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se në javët e ardhshme do të gjendet një zgjidhje për ndërtimin e rrugës Deçan - Plavë. Pas takimit me përfaqësuesit e komunës dhe të manastirit të Deçanit, ai ka thënë se zgjidhja për ndërtimin e kësaj rruge do të jetë e pranueshme për të gjitha palët | FAQE 3

### Veseli: PDK-ja është opozitë e pushtetit, jo e shtetit | FAQE 5



#### OPINION

NUK ËSHTË ASPAK  
E VËRTETË SE UÇK-ja KA  
QENË E ÇORGANIZUAR (36) F. 11

Shkruan:  
Kudusi LAMA



#### AKTUALE



SHBA-ja I DHURON KOSOVËS  
50 RESPIRATORË F. 2

THAÇI KËRKON NDRYSHIME  
KUSHTETUESE PËR MANDATIN E  
GJYKATËS SPECIALE F. 2

#### EKONOMI

KORONAVIRUSI MBYLLI  
MBI 400 BIZNESE NË KOSOVË F. 9

ARBITRAZHI LEHTËSON  
ZGJIDHJEN E KONTESTEVE  
BIZNESORE F. 9

#### KULTURË

MINISTRJA DUMOSHI: MKRS-ja  
E FOKUSUAR PËR PËRKRAHJEN  
E NDËRMARRËSVE TË RINJ F. 6



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Thaçi kërkon ndryshime kushtetuese për mandatin e Gjykatës Speciale

PRISHTINË, 25 GUSHT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, edhe zyrtarisht i është drejtuar kryesisë së Kuvendit të Kosovës me propozim për amendamentin e Kushtetutës për zgjatjen e mandatit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë.

Bazuar në amendamentin e Kushtetutës së Kosovës, në bazë të të cilit janë formuar Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës me seli në Hagë, që njihet si Gjykata Speciale për Krime të Luftës në Kosovë, mandati pesëvjeçar i këtij institucioni skadon në gusht të këtij viti. Megjithatë, në Ligjin për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian thuhet se mandati i kësaj gjykate do të përfundojë atëherë kur Këshilli i Bashkimit Evropian do t'i lajmërojë për këtë institucionet e Kosovës, gjë që konfirmohet edhe në vetë këtë gjykatë.

Thaçi në propozimin e vet dërguar Kryesisë së Kuvendit ka kërkuar të ndryshohet neni i

amendamentit, ku thuhet se mandati i këtij institucioni do të zgjasë për një periudhë pesëvjeçare. Sipas propozimit të Thaçit, mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar "do të zgjasë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet nga Këshilli i Bashkimit Evropian, në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës".

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kundër të cilit tashmë është paraqitur një aktakuzë për shqyrtim për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit pranë kësaj gjykate, të hënën në mbledhje përmes një video-mesazhi në rrjetin social "Facebook", ka thënë se shpreson se deputetët do ta mbështesin këtë kërkesë. Sipas tij, "mbështetja e drejtësisë për të bërë drejtësi e nderon Kuvendin e Kosovës dhe rrit përgjegjësinë e shtetit të Kosovës".

Sipas Kushtetutës, ndryshime kushtetuese mund të propozojnë qeveria, presidenti ose një e katërta e deputetëve të Kuvendit dhe çdo ndryshim



kërkon miratimin e dy të tretave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat nga radhët e komuniteteve. Po ashtu, Kushtetuta parasheh që ndryshimet mund të miratohen

nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i

propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kushtetutë. Për këtë çështje më pas duhet të vendosë paneli kushtetues i Dhomave të Specializuara në Hagë.

## Ndërtesa e ish-burgut të Prishtinës pritet të shndërrohet në Muze



PRISHTINË, 25 GUSHT (ER) - Nga e marta edhe zyrtarisht nis projekti i shndërrimit të ndërtesës së ish-burgut në Prishtinë në muze. Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka nënshkruar vendimin për formimin e grupit punues që do ta hartojë konceptin për

projektin e ndërtesës së ish-burgut të Prishtinës me destinim muze, të cilin koncept do t'ia paraqesë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Grupi punues me vendim të ministres do të ketë këtë përbërje: Vjollca Aliu, drejtoreshë e Departamentit

të Trashëgimisë në rolin e kryesueses; ndërkaq në rolin e anëtarëve: Profesor Luan Mulliqi, anëtar korrespondent i Akademisë; Bislim Zogaj, drejtor i AMKMK-së; Xhavit Loshaj, këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë; Hydajet Hyseni, kryetar i Shoqatës së Burgosurve Politik të Kosovës;

Meriman Braha, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës; Fikrije Berisha, zyrtare e Agjencisë së Arkivave të Kosovës dhe dr. Haxhi Ademi nga Instituti i Historisë dhe Ajshe Kamberi, MPB. Ky vendim shënon hapin e parë konkret drejt

shndërrimit të objektit të ish-burgut të Prishtinës në muze dhe është një akt i ndërmarrë nga ministrja Dumoshi konform programit të qeverisë Hoti. Në të ardhmen i njëjti do të menaxhohet dhe administrohet nga MKRS-ja me funksionin muze.

Ministrja Dumoshi tha se ky vendim është marrë duke pasur në konsideratë ndjeshmërinë e çështjes, kompleksitetin e ndërtesës, duke përfshirë edhe aspektin shoqëror dhe historik. "Shndërrimi i ndërtesës së ish-Burgut të Prishtinës me destinim muze shënon një hap të rëndësishëm për dokumentimin e së kaluarës tonë, krijimin e një hapësire të përshtatshme dhe të nevojshme për t'i institucionalizuar përjetimet e të burgosurve shqiptarë të Kosovës nën regjimin jugosllav e më pas atë serb. Muzeu i cili do të jetë si rezultat final nga vendimi i sotëm, do të shërbejë si një kujtesë e sakrificës që kanë bërë shqiptarët e Kosovës në rrugëtimin drejt lirisë dhe pavarësisë së shtetit tonë", u shpreh ministrja Dumoshi.

Kryeministri Avdullah Hoti ka vizituar Komunën e Deçanit

# Hoti: Në javët e ardhshme gjendet zgjidhja për rrugën Deçan - Plavë

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se në javët e ardhshme do të gjendet një zgjidhje për ndërtimin e rrugës Deçan - Plavë. Pas takimit me përfaqësuesit e komunës dhe të manastirit të Deçanit, ai ka thënë se zgjidhja për ndërtimin e kësaj rruge do të jetë e pranueshme për të gjitha palët



përkrahim idenë e zhvillimit ekonomik të komunës, por është me rëndësi që të kemi parasysh se ekziston Ligji për zonat e mbrojtura speciale, që nuk lejon që rrugët magjistrale

të ndërtohen në zonat e mbrojtura, dhe kjo do të ishte rrugë e karakterit magjistrale ndërkombëtare sepse lidhet me Malin e Zi", është shprehur ai.

Janjiq ka thënë se ndërtimi i rrugës afër manastirit do të krijonte zhurmë. "Kemi biseduar për mënyra të ndryshme se si të gjendet një zgjidhje e përhershme e cila do të jetë në përputhje me ligjin dhe e cila do t'i përmbushë nevojat ekonomike të komunës, nga ana tjetër interesin për një jetë të qetë siç është e paraparë me ligj", ka deklaruar Janjiq.

Ndërsa kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se është në interes të qytetarëve që rruga të vazhdohet. Ai ka deklaruar se janë të përkushtuar që të gjejnë një zgjidhje sa iu përket punimeve në këtë rrugë.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 2016 kishte marrë vendim, sipas të cilit, Manastirit të Deçanit i njihet e drejta e pronësisë për 24 hektarë tokë. Por, ky vendim nuk është zbatuar asnjëherë nga ana e

kësaj komune. Zyrtarë të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë në vazhdimësi kanë bërë thirrje që të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Në vitin 2008 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Zona të Veçanta të Mbrojtura, i cili duhet ta sigurojë mbrojtjen e manastireve ortodokse serbe, kishave, vendeve të tjera fetare, si dhe vendeve historike dhe kulturore të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb si dhe për komunitetin e tjera në Republikën e Kosovës.

Manastiri i Deçanit është një nga zonat e mbrojtura, sipas këtij ligji. Sipas ligjit, në këto zona janë të ndaluara aktivitetet e ndryshme, si: ndërtimet apo zhvillimet industriale, të tilla si eksplorimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale dhe ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe rrugëve transite në zonat rurale; dhe ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se së shpejti do të gjendet një zgjidhje për ndërtimin e rrugës Deçan - Plavë. Pas vizitës që i ka bërë kësaj komune dhe manastirit, Hoti ka treguar se zgjidhja duhet të gjendet sipas ligjeve të Kosovës. "Sot vizitova Komunën e Deçanit. E takova kryetarin Bashkim Ramosaj. Me të vizituar Manastirin e Deçanit, ku u pritëm nga ati Sava Janjiq. Diskutuam për çështje të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Deçanit, në veçanti për çështjen e rrugës së Manastirit. Ne kemi kulturë institucionale edhe si komunë, edhe si qeveri për t'i respektuar ligjet që janë nxjerrë nga Kuvendi i

Republikës së Kosovës, për t'i respektuar vendimet që i nxjerrin institucionet tona vendore", ka thënë Hoti në deklaratën për media.

Ai ka thënë se zgjidhja do të jetë e pranueshme për të gjitha palët. "Biseduam që në javët e ardhshme të gjejnë një zgjidhje që është e pranueshme për të gjithë, duke mbrojtur kështu interesat e qytetarëve, edhe interesat e Manastirit të Deçanit si një vend i veçantë i trashëgimisë sonë kulturore e botërore", ka thënë Hoti.

Kurse igumeni i manastirit të Deçanit, Sava Janjiq, pas takimit me kryeministrin, ka thënë se e përkrahin ndërtimin e rrugëve që lidhin njerëzit. Mirëpo, sipas tij, duhet respektuar edhe ligjet për zonat e mbrojtura. "Ne e përkrahim ndërtimin e rrugëve që lidhin njerëzit dhe



## Ministri Likaj mori vendim për ndarjen e bursave për vitin akademik 2019/2020

PRISHTINË, 25 GUSHT (ER) - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka marrë vendim për ndarjen e bursave për studentët elitare

të universiteteve publike, të niveleve bachelor dhe master për vitin akademik 2019-2020.

Përfitues të bursave janë 1

516 studentë të dy niveleve të studimit bachelor dhe master. Shuma e bursës për student është 700 euro.

MASH njofton të gjithë

studentët përfitues të bursës se, pas shqyrtimit të ankesave të mundshme, do të bëhet rimbursimi i mjeteve brenda një afati të shkurtër.





Bëhet thirrje për konsensus nacional për procesin final të dialogut me Serbinë

# BASHKEPUNIMI POZITË - OPOZITË FORCON POZICIONIN E KOSOVËS NË DIALOG ME SERBINË

Bashkëpunimi i pozitës dhe opozitës për dialogun me Serbinë do ta forconte pozicionin e Kosovës në këtë proces kanë bërë me dije udhëheqësit e koalicionit qeverisës dhe njohësit e rrethanave politike në vend. Ata kanë vlerësuar se nëse spektri politik do të bashkohej për këtë çështje, dialogu me Serbinë për njohje reciproke do të jetë më përmbajtjesor dhe më i qëndrueshëm. Mirëpo opozita ka refuzuar qasjen e qeverisë ndaj dialogut me Serbinë. Lëvizja Vetëvendosje ka vlerësuar se ky proces do t'i sjellë Kosovës "Zajednicën" ose shkëmbimin e territoreve me Serbinë

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 24 GUSHT - Liderët e koalicionit qeverisës dhe njohësit e rrethanave politike kanë kërkuar unitetet të spektrit politik për dialogun me Serbinë. Ata kanë thënë se bashkëpunimi i pozitës dhe opozitës për këtë proces do ta forconte pozicionin e Kosovës në Uashington dhe në Bruksel.

Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka

thënë të martën se proceset politike nëpër të cilat po kalon Kosova kërkojnë bashkëpunimin e të gjithë aktorëve politikë. "Proceset politike me të cilat po ballafaqohet vendi kërkojnë bashkëpunim dhe besim reciprok të të gjithë aktorëve. Dialogu me Serbinë për njohje reciproke, qoftë në Uashington apo në Bruksel, do të jetë më përmbajtjesor dhe më i qëndrueshëm nëse aksionarë të këtij dialogu janë pozita dhe

opozita. Ndërkaq, strategjia e dialogut duhet të jetë çështje që diskutohet dhe formulohet nga kryeministri dhe kabineti i tij i ngushtë me partnerët e koalicionit dhe liderët e opozitës", ka deklaruar Mustafa. Ai ka kërkuar nga partnerët e koalicionit që të mos flasin në publik për strategjinë e Kosovës në këtë proces. "Pa marrë parasysh arsyen dhe nevojën e komunikimit me publikun, duhet të kemi kujdes që për strategjinë tonë të mos marrë

vesh Serbia përmes debateve në studiot tona televizive dhe përplasjeve të brendshme, sepse kjo në start e dëmton pozicionin dialogues të kryeministrit tonë", ka vlerësuar Mustafa.

Një ditë më parë liderët e koalicionit qeverisës janë takuar për të gjetur një gjuhë të përbashkët për këtë proces, para takimit të Uashingtonit, i cili do të mbahet më 4 shtator. Pas takimit, lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka deklaruar se partnerët e koalicionit qeverisës janë pajtuar për këtë takim. "Ka qenë një shqetësim i përbashkët dhe, në fund, një marrëveshje e përbashkët, që Kosova do të vazhdojë të marrë pjesë në dialog, me agjendë të qartë, me principe të qarta. Ato kompromise që i ka bërë Kosova, heqja e taksës dhe reciprociteti dhe të gjitha ato kërkesa për t'u kthyer në dialog, i ka bërë për njohje. Ne shkojmë në dialog për njohje", ka thënë

ai.

Edhe njohësit e rrethanave politike kanë bërë thirrje për unitet rreth këtij procesi.

Analisti Faton Abdullahu mendon se mosuniteti i spektrit politik do ta dëmtojë pozicionin e Kosovës në këtë proces. "Po vazhdojmë të mos jemi unikë si në këtë qeveri, si në atë para kësaj, edhe përkundër faktit se po bindemi pandalshëm sa agresive, por edhe e bashkuar është Serbia kundër nesh. Sa më të përçarë aq më shumë do të zvogëlohen mundësitë që të përfitojmë ndonjë gjë nga dialogu me Serbinë", ka deklaruar Abdullahu për gazetën "Epoka e re". Sipas tij, nuk e ndihmon askush Kosovën nëse spektri politik është i përçarë. "E pakuptueshme prej nga kjo prirje noshalante për të mos u bërë bashkë së paku në përballje me Serbinë. Të përçarëve nuk u ndihmon as Zoti e as Amerika. Shqiptarëve u është rikthyer një e metë e vjetër

ku, inati po u bëhet më i madh se arsyeja e ky inat u vjen, si duket, nga grykësia për të shukur sa më shumë pushtet. Nuk shpresoj shumë se kjo do të tejkalohet lehtë ndërmjet partnerëve të koalicionit aktual”, ka thënë Abdullahu.

Kurse analisti tjetër Ilir Ibrahim ka bërë me dije se spektri politik nuk duhet ta shfrytëzojë çështjen e dialogut me Serbinë për interesa të brendshme të luftës ndërpartiak. “Mospajtimet e partnerëve të koalicionit nuk janë të shëndosha në procese të tilla, ku interesi vital i vendit është në pyetje. Fatkeqësisht, spektri politik i Kosovës për një kohë të gjatë e ka shfrytëzuar çështjen e dialogut dhe çështje të tjera të politikës së jashtme për interesa të brendshme të luftës ndërpartiake. Qeveria e Kosovës duhet të ndërtojë një konsensus sa më të gjerë për dialogun. Fatkeqësisht, një gjë të tillë nuk po e shohim ende dhe kjo kam frikë do të vazhdojë të na dëmtojë”, ka thënë ai për gazetën “Epoka e re”. Sipas Ibrahimit, për çështje të interesit nacional nuk duhet të ketë inate dhe teke personale. “Spektri politik i Kosovës është i vetëdijshëm se dialogu me Serbinë është i një rëndësie nacionale. Këtë duhet ta dëshmojë edhe me veprime konkrete. Për çështje të interesit nacional nuk mund të ketë inate dhe teke personale, por të gjithë

duhen bërë bashkë për ta çuar atë interes përpara. Nëse kemi arritur të bëhemi bashkë në kohë lufte, atëherë është pakuptueshme se si nuk arrijmë ta bëjmë një gjë të tillë sot kur jemi shtet i pavarur”, ka deklaruar ai.

### Vetëvendosja kundër dialogut

Por opozita vazhdon të refuzojë që t'i bashkohet qeverisë në procesin e dialogut me Serbinë. Ish-ministri i Punëve të Jashtme dhe zyrtari i lartë i Vetëvendosjes, Glauk Gonjufca, ka akuzuar partitë në pushtet se me këtë proces po e aktualizojnë marrëveshjen e Brukselit për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe (AKS), të cilën e ka rrëzuar Gjykata Kushtetuese. Në një konferencë për media, në pesëvjetorin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Konjufca ka thënë se si “Zajednica”, rrezik për Kosovën paraqet edhe projekti për ndarje ose shkëmbim të territoreve me Serbinë. “Sot është 5-vjetori i nënshkrimit të Zajednicës, në të cilën e pat hedhur nënshkrimin kryeministri i atëhershëm Isa Mustafa. Fatmirësisht marrëveshja u hodh poshtë nga Kushtetuesja, pasi në 23 pika u shpall jokushtetuese, por për shoqërinë, shtetin dhe popullin tonë ka qenë shumë tronditëse deri në cilën pikë mund të

## BE: Më 27 gusht vazhdon dialogu Kosovë - Serbi në nivel ekspertësh

Burimet e Bashkimit Evropian kanë konfirmuar të martën për Radion Evropa e Lirë se më 27 gusht në Bruksel do të zhvillohet një takim i radhës në nivel ekspertësh në kuadër të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Nabila Massrali, zëdhënëse e BE-së për Çështje të Jashtme dhe Siguri, ka konfirmuar zhvillimin e këtij takimi të enjten, por pa dhënë hollësi të tjera. “Dialogu i rifilluar në nivelin më të lartë në muajin korrik vazhdon me një varg takimesh në nivel ekspertësh si pjesë e procesit në vazhdim e sipër. Ne mund të konfirmojmë se takimi i radhës do të



zhvillohet më 27 gusht. Si rregull ne nuk bëjmë komente për diskutimet që janë në vazhdim e sipër”, ka thënë ajo. Burimet diplomatike në BE kanë paralajmëruar se në fillim të shtatorit do të mund të zhvillohet edhe një raund i

takimit në nivelin e lartë mes kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Në Bruksel deri më tani është biseduar për të pagjeturit, të zhvendosurit dhe për bashkëpunimin ekonomik.

shkojnë politikanët që e përfaqësonin vendin në atë kohë”, ka thënë ai, duke shtuar se tani në tavolinë të bisedimeve janë dy opsionet. “Pse po ia kushtojmë këtij projekti të rrezikshëm këtë konferencë? Në vend që të shpallej e vdekur Zajednica pas vendimit, ajo është

më aktuale se kurrë tash kur jemi në prag të asaj që po quhet faza finale e dialogut. Fatkeqësisht në LDK dhe në partitë e PAN-it ka dy lloj të politikanëve, pro Zajednicës dhe pro shkëmbimit të territoreve. Prandaj duhet të ngrehim këtë çështje, pasi është vetëm LV-ja që i refuzon dhe i

kundërshton të dyja”, ka thënë Konjufca. Sipas tij, këto duhet të kundërshtohen nga të gjithë ata që përfaqësojnë Kosovën në dialog. “Edhe shkëmbimi, edhe Zajednica janë sinonime të ndarjes së Kosovës. Zajednica është njëfarë bosnjëzimi i Kosovës”, ka thënë Konjufca.

## Veseli: PDK-ja është opozitë e pushtetit, por jo e shtetit

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka qëndruar të martën në Prizren, ku ka takuar kryesinë e degës së partisë dhe strukturat udhëheqëse. Veseli ka kërkuar mobilizim sa më të madh për t'ua rikthyer qytetarëve prizrenas besimin në PDK me qeverisje të mirë. “Do t'u përgjigjemi me dinjitet dhe integritet të gjitha zhvillimeve që lidhen me interesin nacional të vendit. PDK-ja është opozitë e pushtetit, por jo e shtetit”, ka thënë Veseli



Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka vizituar edhe strukturat e partisë në Dragash.

Veseli në këtë takim ishte i shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm i PDK-së, Uran Ismaili, anëtari i kryesisë, Enver Hoxhaj, sekretari elektoral, Betim

Gjoshi.

Kryetari i PDK-së ka përgëzuar lidërsipin dhe anëtarët e kësaj partie për punën e mirë që po bëjnë. Njëherësh, ka kërkuar edhe më shumë mobilizim e angazhim në shërbim të qytetarëve. Ai ka theksuar se PDK-ja është e konsolid-

uar dhe strukturuar fuqishëm në Dragash dhe gjithandë Kosovës. “Do t'u përgjigjemi me dinjitet dhe integritet të gjitha zhvillimeve që lidhen me interesin nacional të vendit. PDK-ja është opozitë e pushtetit, por jo e shtetit”, ka thënë Veseli.

**EPOKA E RE**

**Qendresa RAMA**

**PRIZREN, 25 GUSHT** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka qëndruar në Prizren, ku ka takuar kryesinë e degës së partisë dhe strukturat udhëheqëse. Në këtë takim është diskutuar për organizimin e mëtejshëm në funksion të zgjedhjeve të ardhshme lokale. Veseli ka kërkuar mobilizim sa më të madh për t'ua rikthyer qytetarëve prizrenas besimin në PDK dhe me qeverisje të mirë. “Kosova ndodhet para sfidave të mëdha nacionale dhe politike.

PDK-ja është e vetëdijshme për këtë situatë dhe, sikurse më herët, ka ditur të silltet karshi nevojave të shtetit. Fitoret e PDK-së duhet të nisin nga Prizreni, për t'ua kthyer qytetarëve besimin dhe shërbyer atyre me devotshmëri. Pushteti aktual po tregon çdo ditë se nuk di dhe nuk mund të qeverisë më mirë” ka thënë Veseli.

Kryetari i Degës së PDK-së në Prizren, Shaqir Totaj, ka falënderuar kryetarin Veseli dhe bashkëpunëtorët për takimin, duke premtuar angazhim e mobilizim edhe më të madh të partisë.

# Nderohen dëshmorët e Brigadës 121 'Ismet Jashari-Kumanova'

**MALISHEVË-KLEÇKË, 25 GUSHT (ER)** - Të martën në varrezat e dëshmorëve të Brigadës 121 "Ismet Jashari-Kumanova" në Kleçkë janë bërë homazhe dhe nderime në ditën e dëshmorëve të kësaj brigade. Nderimet dhe homazhet u bënë në kuadër të 22-vjetorit të rënies së dëshmorit Ismet Jashari-"Kumanova" dhe dëshmorëve të tjerë të Brigadës 121.

Krahas zyrtarëve të lartë të shtetit dhe udhëheqësve të institucioneve të Republikës së Kosovës, homazhe në nderim të dëshmorëve të Brigadës 121 të UÇK-së kanë bërë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, së bashku me anëtarët e qeverisë komunale, si dhe familjarë të dëshmorëve.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se vijnë çdo vit në Kleçkë për ta nderuar jetën dhe

veprën e bashkëluftëtarëve që dhanë jetën për lirinë e Kosovës. "Në këtë datë të vitit 1998 në vijën e frontit kanë rënë pesë bashkëluftëtarë në krye me Ismet Jashari-'Kumanovën'", ka thënë ai.

Limaj ka theksuar se krejt kjo që kemi është falë sakrificës maksimale të djemve dhe vajzave të trojeve shqiptare të cilët dhanë jetën për lirinë e Kosovës. "Ata vullnetarisht janë përcaktuar për ta dhënë jetën për lirinë e Kosovës. Këto shenja janë dëshmia e gjallë për ne të gjallët që t'i kujtojmë e t'i nderojmë për ata që bënë gjithçka për lirinë e Kosovës dhe për të treguar se çka do që të bëjmë për Kosovën është pak krahasim me ata çka kanë bërë për ta gëzuar lirinë. Lavdi dëshmorëve të Brigadës 121 Ismet Jashari-'Kumanova'! Lavdi dëshmorëve të Kombit!", ka thënë kryetari Limaj.



## Ministrja Dumoshi: MKRS-ja e fokusuar për përkrahjen e ndërmarrësve të rinj

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 25 GUSHT** - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka vizituar të martën Qendrën Inovative të Kosovës (Innovation Centre of Kosovo - ICK), për t'u informuar për aktivitetet dhe objektivat që ka kjo organizatë. Ajo është pritur nga drejtuesit e kësaj organizate në krye me drejtorin ekzekutiv të ICK-së, Uranik Begu.

Ndër objektivat kryesore të organizatës në fjalë janë ndërmarrësia për të rinj, përkrahja për nisjen e bizneseve (start-up) për të rinj për krijimin e vendeve të reja të punës përmes inovacionit duke ofruar mbështetje në edukim në fushat e teknologjisë dhe ndërmarrësisë. Me këtë rast, ministrja Dumoshi ka thënë se ndihet e kënaqur për arritjet e organizatës e cila u ka mundësuar shumë të rinjve të trajnohen dhe më pas ose të hapin vetë biznese ose të përfundojnë si të punësuar.



Dumoshi ka folur për rëndësinë dhe rolin e MKRS-së në fushën e ndërmarrësisë dhe ka theksuar se partneriteti me palët që janë të përfshira në këtë fushë është e rëndësishme. "Jam e interesuar që ta rrisë partneritetin publiko-privat në

mënyrë që të rinjve t'u ofrohen mundësi më të mëdha punësimiti, që si qeveri, e sidomos ne si ministri që mbulojmë dikasterin e rinisë, të ndërmarrim veprime konkrete për krijimin e vendeve të reja të punës", ka pohuar

ministrja Dumoshi, duke theksuar se vendi ynë ka shumë të rinj të talentuar. "Si ministri po ndryshojmë dhe plotësojmë dokumentet ligjore dhe strategjike të cilat do ta mundësojnë rritjen e punësimit të të rinjve. Aftësimi profesional

i të rinjve, duke përfunduar në tregun e punës, është një prej objektivave me prioritet që kam si ministre dhe këta të rinj, përpos që do të punojnë për tregun e brendshëm të Kosovës i cili nuk është edhe aq i madh, do të punojnë edhe për tregun e jashtëm, të cilët do të ndikojnë në rritjen eksportit në njërin anë dhe të ardhurave për vendin tonë", ka vlerësuar ministrja Dumoshi.

Nga ana e tij, drejtori Begu e ka informuar ministren Dumoshi me punën që bën ICK-ja për trajnimin e shumë të rinjve, për përkrahjen e start-upeve për bizneset e reja dhe përkrahjen e shumë projekteve inovative të cilat kanë depërtuar edhe në tregun global. Ministrja Dumoshi ka thënë se është e rëndësishme strategjike që rrëfime suksesi sikurse ICK-ja të përkrahen nga institucionet vendore për t'i marrë shërbimet e mira që ofron kjo organizatë ashtu që mbështetja financiare të përqendrohet përbrenda vendit dhe jo të dalë jashtë shtetit.

## Veliu pret në takim ambasadorin gjerman, temë diskutimi vizat

**PRISHTINË, 25 GUSHT (ER)** - Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, me të cilin ka biseduar për tema

të ndryshme që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë në vend, aktualitetin politik, si dhe për bashkëpunimin e mirë në projekte që përmirësojnë jetën dhe mirëqenien e qytetarëve. "Ambasadorin z.

Rohde e njoftova me prioritetet për Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku rol kyç ka luftimi i të gjitha formave të krimit. Në mënyrë të veçantë diskutuam për çështjen liberalizimit të vizave, proces në të

cilin përkrahja gjermane është jetike. Diskutuam edhe për procese të tjera të rëndësishme siç është njohja e ndërsjellë e patentëshoferëve", ka thënë Veliu pas këtij takimi.



# Edhe tetë të vdekur në 24 orët e fundit nga Covidi në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se ka shkuar në 12 683 numri i përgjithshëm i të infektuarve me Covid-19 pasi që vetëm në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe 136 raste të reja. Sipas IKShPK-së, gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë edhe tetë pacientë të cilët ishin të prekur me Covid-19 dhe numri i përgjithshëm i viktimave ka shkruar në 488. Po gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 131 persona dhe numri i përgjithshëm i të shëruarve është 8 788

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 GUSHT - Në Kosovë u konfirmuan të martën edhe tetë viktima nga Covid-19. Me këtë shifër, sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, numri i përgjithshëm i viktimave nga kjo sëmundje arrin në 488. IKShPK-ja, po ashtu, ka bërë me dije se në 24 orët e fundit ka testuar 471 mostra, nga të cilat janë konfirmuar 136 raste të reja me Covid-19.

Që nga regjistrimi i rasteve të para më 13 mars, Kosova ka shënuar në total 12 683 raste pozitive.

Prej tyre, 8 788 pacientë janë

shëruar - 131 nga ta në 24 orët e fundit, njoftoi IKShPK-ja. Raste aktive aktualisht janë 3 407.

Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe në spitalet rajonale aktualisht janë të shtrirë 499 pacientë, prej këtyre 387 të prekur me koronavirus. Në raportin ditor të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës thuhet se 10 pacientë janë të vendosur në respiratorë, 25 në makinat e frymëmarrjes CPAP, ndërsa 330 të tjerë janë duke u trajtuar me oksigjenoterapi.

QKUK-ja dhe spitalet rajonale kanë kapacitet prej 700 shtretërisht.

## Licencohen edhe 11 laboratorë për kryerje të testeve serologjike

Ministria e Shëndetësisë në Kosovë ka bërë me dije të martën se ka licencuar edhe 11 laboratorë për kryerje të testeve serologjike për koronavirus. Përmes këtyre testeve, një person e kupton nëse është prekur në të kaluarën me koronavirus, apo nëse ka krijuar anti-trupa ndaj tij. Marrë parasysh njoftimin e fundit, në gjithë territorin e Kosovës deri më tani janë licencuar 98 laboratorë për kryerje të testeve serologjike dhe virologjike për sëmundjen Covid-19. Për dallim

nga testet serologjike, testet virologjike që aktualisht kryhen edhe në dy laboratorë privatë në Kosovë - përcaktojnë nëse një person është i infektuar me koronavirus në kohën kur testohet. Më 10 gusht, Ministria e Shëndetësisë ka nisur lëshimin e licencave për institucionet private shëndetësore që ato të kryejnë teste për Covid-19. Më parë këtë shërbim e kryente vetëm Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK).

## ShBA-ja i dhuron Kosovës 50 respiratorë

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 GUSHT - Ambasada e Shteteve të Bashkuara përmes Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) i ka dhuruar Kosovës 50 respiratorë tërësisht të ri dhe nga më bashkëkohorët për të ndihmuar në luftën kundër Covid-19. "Ky donacion paraqet realizimin e ofertës zemërgjerë të presidentit Trump për furnizim me pajisje të domosdoshme dhe mbështet Kosovën në përgjigjen urgjente ndaj pandemisë", bëhet me dije në njoftimin e Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë.

Respiratorët e markës "Vyaire", të prodhuar në Shtetet e Bashkuara, pasqyrojnë teknologjinë më të fundit për të cilën ka kërkesë të madhe. "Ata janë kompaktë dhe do t'i mundësojnë Kosovës fleksibilitet më të lartë për trajtimin e pacientëve të prekur nga virusi. Kjo pajisje vitale mund të dëshmojë si shpëtimtare për pacientët, mushkëritë e të cilëve nuk funksionojnë si duhet, përkundër marrjes së oksigjenit", theksohet në këtë komunikatë. "Në përgjigje të nevojës së Kosovës për më shumë pajisje mjekësore,



Shtetet e Bashkuara po i dhurojnë 50 respiratorë tërësisht të ri dhe nga më bashkëkohorët. Kjo shprehje e partneritetit tonë ShBA-Kosovë është gjithashtu edhe një shembull i shkëlqyeshëm i bashkëpunimit të zemërgjerësisë amerikane dhe inovacionit të industrisë private amerikane. Shpresojmë që këto aparate mjekësore t'u

mundësojnë ofruesve të shërbimeve shëndetësore anëmbanë Kosovës të shpëtojnë më shumë jetë", ka deklaruar ambasadori Philip Kosnett, theksohet në komunikatë. Krahas respiratorëve, USAID-i po financon edhe një pako mbështetëse e cila përfshin pajisjet shoqëruese, instalimin, garancitë, planet e servisimit

dhe uebinaret në internet. Uebinarët janë zhvilluar në bashkëpunim me Universitetin e Kalifornisë në San Francisco (UCSF) dhe do t'u ndihmojnë punonjësve shëndetësorë të Kosovës që t'i përdorin në mënyrë të duhur dhe të sigurt këta ventilatorë të veçantë. Ky donacion ndërton mbi bazën e ndihmës paraprake në vlerë prej

1.6 milion dollarësh amerikanë që Departamenti i Shtetit i ShBA-së dhe USAID-i kanë obliguar për Kosovën, me qëllim të mbështetjes së masave që ajo po merr kundër pandemisë si dhe ofrimit të ndihmës operationale dhe rritjes së aftësisë reaguese të saj për ta ndaluar përhapjen e mëtejme dhe zbutur pasojat e Covid-19.

# Arbitrazhi lehtëson zgjidhjen e kontesteve biznesore

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 GUSHT - Qendra e Arbitrazhit e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar të martën një forum virtual rreth rëndësisë dhe përfitimeve nga arbitrazhi si metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve gjatë të cilit anëtarët e Odës Amerikane patën mundësi të diskutojnë mbi këtë proces me arbitrit. Në veçanti gjatë këtij forumi u diskutua zgjidhja e kontesteve ekonomike gjatë kohës së pandemisë.

Korab Sejdiu, partner themelues i firmës ligjore "Sejdiu & Qerkini", njëherësh arbitër në Qendrën e Arbitrazhit të Odës Amerikane, duke përmendur sfidat me të cilat po përballlet sistemi ligjor gjatë periudhës së pandemisë, ka

thënë se arbitrazhi si metodë alternative e zgjidhjes së kontesteve gjatë kësaj kohe ka marrë rëndësi jetike. Sejdiu ka deklaruar se bizneset s'duhet të dekurajohen nga mungesa e klauzolës së arbitrazhit, pasi mund të përdorin këtë proces për zgjidhje të kontesteve edhe nëse fillimisht kjo klauzolë nuk ka qenë e përfshirë në kontratën e tyre, nëse të dyja palët janë të pajtimit për një gjë të tillë. Sipas tij, fushatat e ndërjegjësimit ndaj arbitrazhit duhet të fuqizohen më tej sepse, pavarësisht prej efikasitetit të gjykatave në kushte normale, arbitrazhi është gjithmonë një proces i qasshëm dhe fleksibil. Njomëza Zejnullahu, arbitre e Qendrës së Arbitrazhit të Odës Amerikane, njëkohësisht edhe këshilltare e lartë ligjore në programin e USAID-it për Drejtësi Komerciale, theksoi se

ky program është vazhdimisht në mbështetje të aktorëve përkatës për promovimin e procesit të arbitrazhit dhe themelimin e Gjykatës Komerciale.

Zejnullahu potencoi se arbitrazhi si metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve nuk bie ndesh me punën e gjykatave por, në fakt, i mbështet dhe plotëson ato. Sipas saj, të pasurit e një gjykatë e cila i trajton çështjet e natyrës komerciale dhe bashkekziston me arbitrazhin do të jetë shumë e dobishme për bizneset e Kosovës.

Zejnullahu tha se programi i USAID-it për Drejtësi Komerciale po punon afërsisht me institucionet e Kosovës, Odën Ekonomike Amerikane dhe aktorë të tjerë drejt promovimit të arbitrazhit si metodë alternative për zgjidhje

të kontesteve komerciale.

Jason Emmert, arbitër dhe drejtor menaxhues i kompanisë Emert Group në ShBA, theksoi se pandemia Covid-19 ka imponuar një transferim të proceseve ligjore edhe në shtetet e ShBA-së, të cilat deri më tani kanë funksionuar në mënyrë tradicionale fizike. Ai theksoi se gjykatat komerciale dhe arbitrazhi përfitojnë nga njëra-tjetra pasi që arbitrazhi lehtëson barrën e gjykatave, ndërsa kjo periudhë e pandemisë vetëm sa do t'i fuqizojë mekanizmat e zgjidhjes së kontesteve.

Emmert, po ashtu, potencoi se Kosova ka përfituar shumë nga njohja falë sportit, prandaj arbitrazhi i cili përfshin edhe ligjin sportiv është shumë i nevojshëm, marrë parasysh se disa shkelje të ligjeve sportive trajtohen më lehtë përmes këtij

mekanizmi sesa përmes gjykatave.

Fouad El Saddi, arbitër në Qendrën e Arbitrazhit të Odës Amerikane dhe partner menaxhues i zyrës ligjore Saddi në Beirut, tha se në çdo krizë apo sfidë ekziston një mundësi për zhvillim. Sipas tij, për shkak se gjykatat janë të mbingarkuara dhe nuk mund t'i trajtojnë të gjitha çështjet, arbitrazhi po promovohet së bashku me metoda të tjera alternative për zgjidhjen e kontesteve në përgjithësi. Ai potencoi se pandemia Covid-19 ka krijuar një mundësi të mirë për zhvillimin e arbitrazhit si metodë më e përshtatshme për zgjidhjen e kontesteve, derisa ndau me pjesëmarrësit e forumit se në shtetin e Libanit arbitrazhi po promovohet përmes shembujve të rasteve të zgjidhura përmes kësaj metode.



## Në Komunën e Rahovecit, 37 milionë euro humbje nga Covid-19

RAHOVEC, 25 GUSHT (ER) - Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në bashkëpunim me Institutin për Ndërmarrësi dhe Biznes të Vogël (IESB) dhe Integra Consulting Sh.PK, ka bërë vlerësimin e ndikimit të pandemisë Covid-19 në ekonominë e Komunës së Rahovecit. Sipas njoftimit të komunës, qëllimi kryesor i këtij

hulumtimi është mbledhja dhe përpunimi i të dhënave ekonomike me qëllim të vlerësimit të dëmit ekonomik të shkaktuar nga pandemia Covid-19 në Komunën e Rahovecit dhe nxjerrja e rekomandimeve për masat sajuese për rimëkëmbjen e ekonomisë pas pandemisë. "Këto informata do të shërbejnë për t'i përcaktuar hapat e ardhshëm të komunës për t'i adresuar problemet dhe sfidat e bizneseve

si dhe ekonomive familjare. Sipas këtij vlerësimi, në ekonominë e Komunës së Rahovecit, duke përfshirë edhe bujqësinë, humbjet e krijuara gjatë kësaj periudhe janë rreth 37 milionë euro. Humbjet janë kryesisht nga bizneset që operojnë në Komunën e Rahovecit, humbjet e vendeve të punës, taksa dhe tatimet e pa-inkasuar, si dhe humbje të ndryshme gjatë kësaj kohe", ka njoftuar Komuna e Rahovecit.





# Koronavirusi mbylli mbi 400 biznese në Kosovë

Kryetari i Agjencisë Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, thotë se numri i bizneseve të mbyllura është rreth 5 000. “Në bazë të informacioneve që ne kemi anembanë vendit, nga pandemia mund të jenë mbyllur rreth 5 000 biznese, një numër i tyre ka falimentuar, një numër tjetër ka pushuar aktivitetin dhe pret ditë të mira dhe një numër i tyre është shuar”

PRISHTINË, 25 GUSHT - Dukagjin Bardhi nga Gjakova katër vjet më parë kishte nisur biznesin për energji të ripërtëritshme por, për shkak të pandemisë Covid-19, në prill të këtij viti ai u detyrua ta mbyllë biznesin.

Bardhi ka shitur gjeneratorë për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme, kryesisht në vende të Evropës. Ai thotë për “Radion Evropa e Lirë” se nuk u ndihmua nga shteti dhe u detyrua t’i largojë punëtorët nga puna dhe ta pushojë biznesin. “Gjeneratorë që prodhojnë energji me erë, energji e ripërtëritshme thirret. Edhe këtu me biznese të Kosovës kemi punuar, por me ndërkombëtarë më shumë, Zvicër, Gjermani, Bullgari... Dhjetë i kam pasur, në kushte normale të lajmëruar. Kur kemi pasur punë shumë, i kemi marrë nga 20 ose 22 punëtorë në ditë, i kemi paguar me orë ose me ditë, varësisht prej porosive që i kemi pasur”, thotë Bardhi.

Njëjtë si ky biznes në Kosovë kanë pësuar edhe qindra të tjerë.

Nga muaji mars kur u konfirmuan rastet e para me koronavirus e deri më 24 gusht, në Kosovë janë mbyllur 447 biznese.

Kryetari i Agjencisë Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, thotë për Radion Evropa e Lirë se numri i bizneseve të mbyllura është rreth 5 000. “Në bazë të informacioneve që ne kemi anembanë vendit, nga pandemia mund të jenë mbyllur rreth 5 000 biznese, një numër i tyre ka falimentuar, një numër tjetër ka pushuar aktivitetin dhe pret ditë të mira dhe një numër i tyre është shuar”, thotë Shahini. Valentina Bytyçi nga Administrata Tatimore e Kosovës thotë për “Radion Evropa e Lirë” se numri i kërkesave për mbyllje të bizneseve dallon prej numrit të bizneseve të çregjistruara. Ajo tregon procedurat se si duhet të mbyllet një biznes në Kosovë. “Deklarimi i të gjitha periudhave, mosmbetja e obligimeve të pashlyera në ATK nga tatimpaguesi si dhe



verifikimi në terren për të shikuar nëse biznesi në fjalë e ka mbyllur aktivitetin e tij dhe nuk është duke operuar. Kur të kryhen të gjitha këto procedura, tatimpaguesi merr certifikatën që e ka të mbyllur aktivitetin e tij, pastaj bëhet çregjistrimi në ARBK”, thotë Bytyçi.

Në seancën e fundit të mbajtur më 14 gusht (e premte) Kuvendi i Kosovës nuk e ka miratuar projektligjin për rimëkëmbje ekonomike. Në bazë të këtij projektligji synohet që përmes politikave fiskale dhe monetare të ndihmohen bizneset, pas humbjeve të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit. Po ashtu, krijohen mundësitë që

kontributpaguesit t’i tërheqin 10 për qind të kursimeve pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, po ashtu lejohet transferimi i 100 milionë eurove nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në buxhetin e Kosovës, për t’u shfrytëzuar për rimëkëmbje të ekonomisë së vendit, të ketë kreditim të bizneseve me kushte më të favorshme, si dhe reduktim të normës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar nga 18 për qind sa është aktualisht, në tetë për qind për hoteleri dhe gastronomi. Me miratimin e këtij ligji mundësohet zbatimi i Pakos për rimëkëmbje ekonomike që kap

vlerën e 385 milionë eurove. Sipas kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, nëse vazhdon kjo situatë deri në fund të vitit, do të mbyllet mijëra biznese. “Me shpresën se do të ketë përkrahje, shumë biznese me shumë vështirësi e kanë shtyrë aktivitetin e tyre. Nëse kjo përkrahje vonohet, atëherë goxha një numër i madh, mijëra biznese, nuk do të mund ta presin pranverën e vitit 2021”, thotë Rukiqi.

Përndryshe, ky ligj do të mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2021. Pas kësaj date, të gjitha dispozitat e këtij ligji do të shfuqizohen në mënyrë automatike.

# Kosova do të përfitojë 138 milionë euro nga BE-ja

Kryeministri Avdullah Hoti ka nënshkruar marrëveshjet financiare ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programet IPA 2019, pjesa 2 dhe IPA 2020. Kosova do të përfitojë në total 138 milionë euro nga BE-ja, ndërsa këto fonde do të zbatohen të kombinuara me më shumë se 40 milionë euro fonde të tjera në formë huamarrjeje nga institucionet financiare ndërkombëtare për projekte të mëdha infrastrukturore nga fusha e mjedisit, energjisë dhe bujqësisë



Qeverisë së Kosovës për disa projekte”, është thënë në njoftimin e Qeverisë së Kosovës. Sipas këtij njoftimi, nga këto programe, përveç të tjerash, Kosova do të përfitojë 20.5

milionë euro si grant në buxhet këtë vit për ta ndihmuar stabilitetin fiskal të vendit dhe 6 milionë euro të tjera vitin e ardhshëm. “Zbatimi i projekteve të financuara nga këto

programe do ta nxisë riaktivizimin ekonomik të vendit dhe do të ndikojë fuqishëm në rimëkëmbjen ekonomike të vendit”, thuhet në njoftim.

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 GUSHT - Kryeministri Avdullah Hoti, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i ka nënshkruar marrëveshjet financiare ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programet IPA 2019, pjesa 2 dhe IPA 2020. “Procedurat për hyrjen në fuqi të këtyre marrëveshjeve do t’i nisnin sa më

parë që të jetë e mundur, kurse me hyrjen e tyre në fuqi Kosova do të përfitojë në total 138 milionë euro nga BE-ja, ndërsa këto fonde do të zbatohen të kombinuara me më shumë se 40 milionë euro fonde të tjera në formë huamarrjeje nga institucionet financiare ndërkombëtare për projekte të mëdha infrastrukturore nga fusha e mjedisit, energjisë dhe bujqësisë, si dhe bashkëfinansim nga ana e

# Miratohet propozim-vendimi për ndarjen e rezervave buxhetore në Komunën e Ferizajt

**FERIZAJ, 25 GUSHT (ER)** - Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Kristina-Gashi-Bytyçi, ka mbajtur mbledhjen e gjashtë të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Në këtë mbledhje drejtoresha e Financave, Sebahate Ajeti-Sadiku, ka bërë propozim-vendim për ndarjen e rezervave buxhetore për vitin 2020. Sipas saj, ky propozim ka ardhur bazuar në shkresën e Ministrisë së

Financave për shfrytëzimin e rezervave buxhetore të komunave. Ajo ka thënë se këto mjete do të ndahen në kuadër të kategorisë së shpenzimeve të rezervave që kanë qenë të parapara për mbulimin e obligimeve eventuale nga Ligji i pagave në sektorin publik. "Meqë ky ligj nuk ka hyrë në fuqi, shfrytëzimi i këtyre mjeteve është rregulluar me nenin 5 të Ligjit për rishikim, ku thuhet se

rezervat në buxhetet komunale, me vendim të ministrit, mund të barten në kategorinë e pagave dhe shtesave, në varësi nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik", është shprehur Ajeti-Sadiku, përdërisa ka bërë me dije edhe bartjen e këtyre rezervave se ku do të bëhen. Pro këtij propozim-vendimi kanë qenë përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike.



## Kryetari Kuçi mban takim me drejtorët e shkollave për fillimin e vitit shkollor

**JUNIK, 25 GUSHT (ER)** - Kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, ka mbajtur takim konsultues me drejtorët e shkollave lidhur me fazën finale përgatitore për fillimin e vitit shkollor 2020-2021. Kryetari Kuçi dhe drejtorët e shkollave kanë diskutuar për mënyrat më të përshtatshme dhe funksionale të fillimit të procesit mësimor në këtë situatë pandemie globale, duke mirëpritur dhe respektuar vendimin e qeverisë dhe Ministrisë së Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2020-2021.

Nga ky takim u theksua se shkollat në Komunën e Junikut kanë bërë të gjitha përgatitjet duke dezinfektuar objektet, furnizuar me dezinfektues, material higjienik dhe janë të gatshme për fillimin e vitit shkollor sipas vendimit të cilin do ta marrë qeveria në përputhje me rekomandimet e IKShPK-së. Në këtë takim u tha se personeli arsimor dhe nxënësit do të njoftohen me kohë nga faqja zyrtare e Komunës së Junikut për çdo vendim që do të marrë qeveria.



## Haziri: Politikat buxhetore dhe financiare në Gjiilan identifikohen me emrin e Zijadin Maliqit

**GJILAN, 25 GUSHT (ER)** - Me rastin e ndarjes nga jeta të drejtorit për Buxhet dhe Financa, Zijadin Maliqi, kryetari i Komunës së Gjiilanit, Lutfi Haziri, i ka dërguar një telegram ngushëllimi familjes Maliqi. Në telegram thuhet: "E dashur familje Maliqi, me pikëllim të thellë e mora lajmin e kobshëm për ndarjen nga jeta të drejtorit për Buxhet dhe Financa, veprimtarit Zijadin Maliqi. Ai do të mbahet në mend si

intelektual jashtëzakonshëm dhe veprimtar i kohëve të vështira, i cili bëri shumë fillimisht si profesor, më pas duke qenë anëtar i Këshillit për Financim të Kosovës, në një kohë të pakohë. Pas luftës ai shërbeu në institucionin e Komunës së Gjiilanit në pozita udhëheqëse dhe u nda nga kjo botë duke qenë në pozitë udhëheqëse si drejtor për Buxhet dhe Financa. Do ta kujtojmë

përgjithmonë si njeri të ndershëm dhe profesionist të jashtëzakonshëm. Mbi të gjitha, politikat buxhetore dhe financiare në Gjiilan e mbajnë emrin Zijadin Maliqi. Jam krenar që e pata bashkëpunëtor për rreth tri dekada. I shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes, shokëve miqve e farefisit. Lamtumirë, miku im!", thuhet në telegramin e Hazirit, drejtuar familjes Maliqi.

## Shprehen shqetësime për zvarritjen e punimeve në ndërtimin e Shkollës Fillore 'Halil Alidemaj'

**VITI, 25 GUSHT (ER)** - Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, i shoqëruar edhe nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Naim Pira dhe përfaqësuesi i Pozheranit, Ilir Zuka, kanë vizituar punimet në ndërtimin e Shkollës Fillore "Halil Alidemaj" në Pozheran, me ç'rast edhe kanë shprehur shqetësimin për zvarritjen e këtij projekti. "Meqenëse ishte paraparë që realizimi i projektit të përfundojë më parë, siç ishte planifikuar, punimet nuk janë duke u kryer

dhe po neglizhohet puna", ka theksuar kryetari Haliti. Ai ka kërkuar nga investitori, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe nga Ministria e Administratës Publike, që të merren me më përgjegjësi për ndërtimin e shkollës sipas planit dinamik të paraparë. "Në cilësinë e kryetarit të komunës, në emër të Drejtorisë së Arsimit, në emër të shkollës dhe këshillit të fshatit dhe këshillit të prindërve, shprehim shqetësimin tonë për

zvarritjen e këtij projekti dhe kërkojmë nga ministritë kompetente dhe operatori ekonomik që e ka fituar projektin, që ta zbatojë planin dinamik për shkak se të gjithë jemi të shqetësuar, meqë punimet kanë ngecur shumë dhe kjo është e patolerueshme", u shpreh Haliti. Përndryshe bëhet me dije se punëkryesi për disa javë nuk ka vazhduar punimet aty dhe kjo ndikuar që të rritet shqetësimi për zvarritje të mëtejme të këtij projekti.



# NUK ËSHTË ASPAK E VËRTETË SE UÇK-JA KA QENË E ÇORGANIZUAR (36)



Shkruan: Kudusi LAMA

Në pikën 36 shpreheni: “Në realitet, veprimtaritë kryesore operative të anëtarëve të UÇK-së para, gjatë dhe menjëherë pas konfliktit kryeshin në territorin shqiptar, ku forcat serbe të sigurimit nuk kanë qenë asnjëherë”. Nuk keni aspak, aspak të drejtë. Të gjitha organet udhëheqëse të Luftës Çlirimtare të Kosovës kanë qenë në Kosovë, nëse doni mund t’i vizitoni të gjitha vendkomandat e tyre, pasi janë të njohura sot. Në Shqipëri kanë lëvizur për nevojat e luftës rast pas rasti individë nga udhëheqësit e luftës me kohë të kufizuara disaditore, por asnjëherë nuk ka pasur çast që ata të kenë funksionuar dhe vepruar në Shqipëri për drejtimin e luftës. Në Shqipëri nuk përjashtoj mundësinë që të ketë pasur qendra luftëtarë për stërvitje prej grupeve të djemve e vashave që shkonin drejt frontit, të cilët qëndronin në kohë shumë të kufizuara, sepse edhe po të tentohej të mbaheshin më shumë ata vetë nuk pranonin, pasi kërkoni të shkonin sa më parë në frontet e luftës. Po kështu në afërsi të kufirit ka pasur edhe vende ku janë grumbulluar armatime, municione e pajisje që futeshin në frontet e luftës. Por të bëhen deklarata të papërgjegjshme dhe të gënjeshtërtë qëllimëqëja siç i bëni ju, është abuzim i rëndë dhe shpërdorim i detyrës për të cilën vërtet ju duhet të jepni llogari para institucioneve që iu kanë ngarkuar me detyrën për të nxjerrë të vërtetën.

Si e keni konsideruar UÇK-në ju në Perëndim, unë e di mirë, por për t’ua sqaruar të gjithë atyre që kanë dëshirë ta kenë të qartë, duhet t’ju them se nuk është aspak e vërtetë që UÇK-ja ka qenë e çorganizuar, siç e cilësoni ju në pikën 37 të raportit. Ajo periudhë vërtet ka qenë e vogël, se pa qenë e vogël nuk mund të bëhej e madhe, pasi ajo është ushtri që u krijua brenda një terreni të pushtuar nga një armik gjakatar, siç ishte Serbia. Kështu që, e çorganizuar ajo nuk mund të bëhej, përkundrazi i duhej një disiplinë shumë e fortë, një unitet i pathyeshëm dhe një mirëkuptim i plotë, e një vigjilencë e padepërtueshme, pasi në të kundërt do të kishin depërtuar agentët e UDB-së dhe do t’i kishin shkatërruar menjëherë. Për ta ditur ju, shqiptarët prej 100-vjetësh në tokat e pushtuara nga Serbia dhe Mali i Zi, asnjë ditë nuk e kanë pushuar luftën. Në vazhdimësi janë bërë kryengritje.

Në vazhdimësi në këto treva kanë vepruar Çeta kryengritëse me vite e me vite, por në fund të gjitha kanë dështuar duke u asgjësuar të gjithë luftëtarët për arsyen e thjeshtë, se në strukturat e tyre kanë depërtuar agentët e fshehtë serbë. E po të ishte e çorganizuar siç thoni ju, do të kishte ndodhur edhe me UÇK-në e njëjta gjë. Por organizimi i saj perfekt ka bërë që ajo të mos lejojë të depërtojë agentët e fshehtë serbë. Por ju jap të drejtë, se ju të dhënat i keni marrë në Beograd e ata kështu e dinë, pasi këtë e keni edhe në librin e gjeneralit Klark “Të bësh luftë moderne”, kur në takim me të, drejtori i përgjithshëm i policisë serbe i thoshte gjeneralit se UÇK-ja ka 410 luftëtarë kur, në fakt, ajo kishte 20 mijë. Nuk befasohej për këtë hallakatje tuajën, pas informacionit shqiptar ju keni deklaruar vetë se nuk besoni në raportin tuaj e ai serb është i pasaktë.

Në pikën 38 ju thoni: “Burimet tona pranë UÇK-së si dhe dëshmi nga anëtarë të UÇK-së të zënë robër nga policia serbe vërtetojnë se bazat kryesore të UÇK-së ku mblidheshin rekrutët e saj ndodheshin në Veri të Shqipërisë”. Këtë çështje unë sapo ua shpjegova më lart, por u mora prapë për faktin se ju nuk keni pasur fare burime pranë UÇK-së gjatë luftës se nuk e keni njohur fare atë dhe së dyti, edhe Serbia nuk ka pasur shumë fat në rëniën robër të luftëtarëve të UÇK-së. Edhe në një rast, më 14 dhjetor 1998 që u zunë 9 luftëtarë në një pritë në malin e Pashtrikut, UÇK-ja i zuri menjëherë 8 ushtarë serb që i shkëmbeu me ndërmjetësinë ndërkombëtare. Kjo ndoshta nuk ka shumë rëndësi si fakt i asaj kohe, por jua thashë vetëm për t’ju treguar se po mashtroni.

Po kështu në pikën 39 prapë ju si gjithnjë i referoheni policisë serbe, se atë e keni burimin e besueshëm, për këtë jam i bindur, por dua të kuptosh mirë, se ata djem e vasha që përbënin UÇK-në nuk ishin kriminelë, dhe ju nuk duhet ta përdorni këtë term, pasi bëni padrejtësi, ata ishin luftëtarë liricë. Por sado të të them të vërtetën, unë jam shqiptar e për ju çfarë thonë shqiptarët nuk duhen besuar. Mirëpo ajo që është shqetësuese, është fakti që ju këtë term kriminel e vini në një dokument që është ndërkombëtar dhe i atribuohet një organizate madhore si Këshilli i Evropës. E që ata do të ecnin nëpër rrugë malore e në fshehtësi është e sigurt se ata ishin duke vepruar në një terren të pushtuar nga armiku. Po ju sa kontradiktor që jeni zotëri, pasi një herë thoni që UÇK-ja furnizohej me kafshë e një herë tjetër drejtuesit e saj i bëni bosa të naftës. Të paktën ta kuptoni abuzimin tuaj me fjalë në këtë raport.

Në pikën 41 të raportit shkruani: “Dhe vetëm në gjashtëmuorin e

dytë të vitit 1998, UÇK-ja arriti të imponohet në mendjen e bashkësisë ndërkombëtare, falë mbështetjes së hapur të fuqive perëndimore bazuar në ‘lobingun’ e Shteteve të Bashkuara, si tehu i luftës së Kosovarëve shqiptarë për çlirimin e Kosovës”. Ne e vlerësojmë shumë mbështetjen ndërkombëtare, në veçanti të ShBA-së, por këtë mbështetje nuk ua dhanë shqiptarëve, mbështetjen e fituan me luftën serioze dhe të drejtë e të ndershme që bënë, ndryshe nga ato çfarë thoni ju në raportin tuaj. Të jeni i sigurt, po të kishin vepruar shqiptarët ashtu siç i akuzoni ju në këtë raport, nuk do të kishin pasur kurrë mbështetjen ndërkombëtare, pasi nuk ishin të gjithë budallenj dhe erdhët ju pas 10 vjetësh për të zbuluar çfarë nuk kishin parë ata. Unë ndihem i lumtur, kur ju e konsideroni ShBA-në “tehu i luftës së kosovarëve shqiptarë për çlirimin e Kosovës”, por edhe ShBA-ja deri kur i njohu luftëtarët e lirisë kush ishin, deri kur vlerësoi organizimin, disiplinën, drejtësinë, ndershmërinë, humanizmin dhe vendosmërinë e tyre nuk i njohu. Dhe kjo ka ndodhur në verën e vitit 1998. Prandaj informohu më mirë, mos hidh gurë kundër shqiptarëve vetëm pse nuk i do, pse je i dashuruar me Serbinë.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka lindur si vullnet i popullit, si domosdoshmëri historike për ta shpëtuar popullin e pushtuar nga asgjësimi, nuk ka lindur si vullnet princërësh, apo personalitetesh të dorës së parë siç i quan ti në raportin tënd në pikën 41. UÇK-ja dhe drejtuesit e saj kishin një mision: ta çlironin vendin nga pushtuesi, se kush do ta merrte drejtimin politik e shtetëror në Kosovën e lirë nuk u ka interesuar fare. Por natyrisht pas çlirimat ata nuk do të arratiseshin nga Kosova, ata që do të mbeteshin gjallë do të merrnin edhe pushtet, ju vjen ose jo mirë ju apo atyre si puna juaj. Për dijeninë tuaj, duhet të them, se mjaft prej udhëheqësve të kësaj lufte të lavdishme, që futën në atë radhë e personaliteteve të dorës së parë, siç i quani ju, sot janë në piedestalin e lirisë pasi ia kanë falur jetën atdheut nëpër frontet e Luftës Çlirimtare, duke u përleshur me forcat e pushtuesit. Në pikën 44, sipas burimeve të brendshme që paskeni pasur ju në UÇK, por të cilën nuk e keni njohur dhe nuk keni dashur ta njihni, dini se si ajo ka ndërtuar kapitalin politik për ta ruajtur përparësinë ndaj grupimeve rivale. Por ju nuk thoni diçka fare të thjeshtë se UÇK-ja e ka bërë politikën me krisma armësh e jo me fjalë. E politikën tjetër me armë në Kosovë nuk ka pasur, përveç asaj të UÇK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit

tuaj se UÇK-ja nuk ka qenë një grupim i vetëm dhe nuk ka pasur një kryekomandant, po ju sqaroj, se ajo ka pasur një hierarki të përsosur, ka pasur një komandë të fuqishme dhe me personalitete të patjetërsueshëm. Ka zbatuar një disiplinë hierarkike që i ka befusuar edhe ushtritë moderne të kohës. Hierarkia e zbatimit të urdhrave ka funksionuar në mënyrë të përsosur, edhe më mirë se në ushtritë klasike të kazermës. Duhet kuptuar se disciplina në zbatimin e urdhrave mund të konsiderohet një nga pikat e forta të suksesit të luftës së saj. Ndoshta për këtë edhe ju zotëri Marty pikërisht këtu kërkoni ta futni atë pykën tuaj të ndryshkur. Asnjë ndarje nuk ka pasur dhe gjithë veprimtaria e saj është zbatuar sipas një plani të detajuar strategjik politiko-ushtarak, me një synim të vetëm të hidhet jashtë pushtuesit e t’i jepet atdheut liria. UÇK-ja ka qenë plotësisht një ushtri konvencionale, veçse nuk i ka pasur armët dhe furnizimin si të ushtrisë serbe, por më të varfra, e kjo nuk konsiderohet dobësi e saj. Në pikat 46-47 ju që në atë kohë paskeni zbuluar një tarafikim të brendshëm me rrënjë të thella që po përcëonte UÇK-në. Athua se nuk e njihni fare Konferencën e Rambujesë, ku delegacioni i UÇK-së foli me një gojë dhe mbajti një qëndrim të spikatur unik e të pandryshueshëm. Ndërsa kur u referoheni ambicieve politike, ju po flisni për të sotmen dhe vetëm po ndëroni kohën, duke e shikuar këtë të sotme të lindur në kohën e luftës, çka nuk ju favorizon, se besoj edhe në Zvicër e vendet e tjera në botë politika partiake bëhet njëllëj si në Kosovë. E kjo nuk konsiderohet përçarje, siç thoni ju, por kërkim i ideve më të mira për ta qeverisur vendin e për ta zhvilluar jetën e qytetarëve duke e përmirësuar atë e duke rritur dinjitetin e shtetit të Kosovës. Në pikën 48 ju bëni një fyerje në ndjenjë duke iu ngjitur prapë idesë tuaj se “Shumë ‘grupëzime’ të ndryshme të UÇK-së u shfaqën në këtë mënyrë më 1998 e 1999, konkretisht pas vdekjes së komandantit të famshëm fshatar të UÇK-së Adem Jashari”. Së pari, duhet t’ju sqaroj se Komandanti Legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, nuk ishte një fshatar i thjeshtë, siç e konsideroni ju, por një komandant që kishte kryer kualifikime të vazhdueshme ushtarake dhe njëjtë në perfeksion strategjinë dhe taktikën e luftës. Së dyti, ai nuk ka vdekur, siç shpreheni ju, por ka rënë duke luftuar heroikisht kundër ushtrisë së pushtuesit për hatër të lirisë së atdheut e të kombit të tij. Së treti, duke rënë Adem Jashari, UÇK-ja nuk u copëtua por, përkundrazi, u bë faktor ndërkombëtar i fuqishëm,

që gëzoi simpatinë dhe përkrahjen e gjithë botës moderne. Së katërti, UÇK-ja është e vërtetë, siç thoni ju, se u shtri “në krejt territorin e Kosovës”, por ajo nuk ishte një ushtri fshatare. Ndoshta ju keni lexuar ndonjë material të vjetër të kohës së Vilhelm Telit, kur flisni për luftë fshatarësh, ose ashtu doni ta prezantoni me qëllim keqdashës Luftën Çlirimtare të Kosovës si luftë fshatarësh, pasi UÇK-ja mbi 70 % (për qind) të luftëtarëve i ka pasur me shkollë të larta e me universitete. Ashtu sikurse luftëtarët e saj nuk kanë qenë të gjithë banorë të fshatrave, siç deklaroni ju, por sipas përqindjes së banorëve në qytete e në fshatra ka pasur luftëtarë edhe nga qyteti edhe nga fshati, po të keni dëshirë mund të merrni adresat e të gjithë luftëtarëve, pasi nuk i kemi të fshehta. Së pesti, Adem Jashari nuk hyri thjesht në folklor si martir, siç e emërtoni ju, por u vlerësua si hero kombëtar, duke u kthyer në nyje uniteti të gjithë popullit shqiptar në Ballkan, dhe duke rreshtuar të gjithë shqiptarët rreth idesë së luftës finale për çlirimin e trojeve të pushtuara nga Serbia. Nuk keni bërë mirë, që keni bërë lojëra të tilla fjalësh, duke përdhosur ndjenjat shpirtërore të shqiptarëve, pasi shqiptarët gjithnjë i kanë nderuar ndjenjat shpirtërore të kombeve të tjera, përfshirë edhe ato të popullit zviceran të cilit i përkisni ju.

Në pikën 49 të raportit tuaj, i quani drejtuesit e UÇK-së “themelues të vetëshpallur të UÇK-së”, por ju nuk mund t’i dini të gjitha, as Serbia, pronarja dhe instruktuesja juaj, nuk mund t’i dijë të gjitha. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk është bandë bashibozukësh, siç doni ta etiketoni ju. Ajo është elita e gjakut kombëtar shqiptar. Për krijimin e saj nuk ka pasur themelues të vetëshpallur, por vendime politike kombëtare. Dhe ajo nuk është ndërtuar sipas njohjeve, por sipas ndjenjave për ta dhënë gjakun për lirinë e atdheut. Po të ishte sipas njohjeve e familjeve, siç doni të krijoni ju ide nëpër botë, nuk do të kishte në radhët e saj luftëtarë e luftëtare nga të gjitha tokat shqiptare, edhe nga diaspora, duke ardhur në radhët e luftëtarëve edhe ata djem e vasha që nuk kanë lindur në Kosovë, por në Zvicër, Gjermani, Suedi, Francë, ShBA etj. Por ju nuk ndaleni, sepse ju duhet t’i thoni të gjitha ato që i kanë thënë serbët para jush. Unë do të t’i evidencoj të gjitha çfarë dhe kur i kanë thënë serbët këto që ju i parashtroni në raport. Dhe po ju them se serbët këto i kanë thënë gjatë gjithë historisë e për problemet që trajtoni ju, i kanë thënë gjatë luftës në vitet 1997 - 1999 e, më së fundi, në vitet 2003 - 2004, kështu që ju jeni i vonuar në këto deklarata.

(Vijon)



Flet akademik Muhamedin Kullashi

## Filozofia dhe letërsia, të pandashme në shumë vepra



Intervistoi: Prof. dr.  
Haqif MULLIQI

Muhamedin Kullashi është intelektual *par excellence*. Është kënaqësi e madhe që të bisedosh me të dhe të përballësh me elokuencën dhe poliedrizmin e tij. Është akademik. Disa vjet ka qenë profesor në Universitetin "Paris 8" në Francë. Është filozof i shquar, vlerësimet për të cilin janë bërë edhe jashtë hapësirave tona. Profesor Kullashi është autor i një numri të madh të veprave nga fusha e filozofisë e që, sipas mendimit tonë, janë libra që ngërthejnë në vete: filozofinë, sociologjinë, ontologjinë, antropologjinë, teorinë e artit dhe poetikën e tij. Krahas angazhimeve si profesor i njërës prej universiteteve më të njohura në botë, atij "Paris 8", profesor Kullashi kontribut të

jashtëzakonshëm ka dhënë edhe për zhvillimin e filozofisë në Universitetin e Prishtinës. Ajo që na ka mahitur gjithmonë është se Muhamedin Kullashi është edhe njohës i pasqorë i fushës së dramaturgjisë dhe teatrit. Titujt e librave të tij janë të shumtë dhe, prej rreth katër dekadash, si rrallëkujt, veprat e tij janë botuar edhe në gjuhën frënge. Profesor Kullashi disa vite ka shërbyer edhe ambasador i parë fuqiptotë i Republikës së Kosovës në Francë. Këtë intervistë me të e kemi realizuar për revistën për letërsi, kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia".

### Të çuditurit (thaumazein tek Aristoteli) dhe ngashënjimi i parë për filozofinë erdhi nga veçantia e të menduarit filozofik

Profesor, a mund të na thoni si ju ka përvetësuar filozofia?  
**KULLASHI:** Së pari dua t'ju falënderoj për këtë bisedë për revistën e mirënjohur "Akademia". Kah filozofia jam orientuar në saje të leximit të

disa teksteve, veçan nga leximi i dialogëve të Platonit, si dhe disa veprave letrare (romane, novela dhe poezi të autorëve të ndryshëm, si nga: Prusti, Dostojevski, Holderlini, Baudelaire, Balzaku etj.), sa isha në Gjimnazin e Pejës. Veprat e këtyre kishin konotacion filozofik, ndonëse artikulohehin me një gjuhë letrare dhe poetike. Dësh fati që në Fakultetin Filozofik të Zagrebit, në mbarim të viteve gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar, brenda Departamentit të Filozofisë të gjej një vatër të kultivimit të mendimit filozofik, me një begati dhe thellësi që më habiti dhe më magjepsi njëherazi. Shkova ta studioj filozofinë në kohën kur *Shkolla Filozofike e Zagrebit* ishte bërë e njohur në qarqet filozofike evropiane dhe amerikane. Të çuditurit (*thaumazein* tek Aristoteli) dhe ngashënjimi vinte nga veçantia e të menduarit filozofik: një mënyrë e të menduarit për njeriun, historinë, shoqërinë dhe natyrën, thelbësisht e ndryshme nga dijet si historia, psikologjia ose sociologjia. Kjo veçanti vërehej së pari në mënyrën e formulimit dhe

shtruarjes së pyetjeve si dhe rrugëtimit të të menduarit. Ligjëratat e para nga filozofia që nxitën *erosin filozofik* kishin të bënin me filozofinë klasike greke: me tema të mendimit të Platonit e të Aristotelit, por edhe të parasokratikëve. Kur pas disa viteve lexova librat e Heideggerit (*Hajdegerit*), *Hyrje në metafizikë* dhe *Çështja fundamentale e metafizikës* kisha përshtypjen se më mirë e kuptoja se në ç'mënyrë çelimi dhe zgjohemi ndaj të menduarit filozofik. Heideggeri shpjegon se filozofët grekë nuk kanë filluar të mësojnë se ç'është "fyzis" në saje të njohjes së fenomeneve "natyrore", por anasjelltas: në saje të një përvojë fundamentale poetike dhe të menduarit filozofik mbi *qenjësimin* (*Sein*) që u hap për ata ajo që quanin "fyzis". Përkthimi i kësaj fjale në gjuhën latine me fjalën "natyra" (proceset e gjërave materiale, atomet etj.), sipas Heideggerit, e deformoi kuptimin *burimor* të "fyzisit". Rrjedhoja e këtij deformimi ka të bëjë me varfërimin e shikimit dhe të njohjes së natyrës në kuptimin burimor, ashtu si u *zbulua* ajo në filozofinë greke. Ajo që u humb me këtë

varfërim semantik shkaktoi "humbjen e relacionit autentik ndaj gjërave". Në kuptimin burimor "fyzis" do të thotë *lulëzim*, bie fjala lulëzimi i trëndafilut ose shpalosja e tij. Lulëzimi dhe shpalosja nënkuptojnë *çeljen* e diçkaje, paraqitjen dhe *qëndrimin* e asaj në këtë çeltësi, por do të thotë edhe rritjen, ndonëse jo në kuptimin sasior. Burimisht, siç thekson Heideggeri, "fyzis" emërton edhe qiellin, edhe tokën, edhe gurin, edhe bimën, kafshën dhe njeriun, por edhe veprat e njerëzve etj. Të filozofuarit është shprehje e një *arti të veçantë të thurjes* së mendimeve, thurje kjo që implikon gjurmime e gjurmime të thella rreth pyetjeve, fjala vjen, që pyesin se ç'është njeriu dhe çfarë raporte ai sajton me veten, me të tjerët dhe me botën.

Çfarë ju ofronin ligjëratat nga filozofia?

**KULLASHI:** Dëgjimi i ligjëratave dhe diskutimeve mbi filozofinë greke si dhe leximi i teksteve nxirrnin në shesh, për mua, *karakterin sublim* të veprave të kësaj filozofie. Thellësia dhe begatia e tyre shoqërohej me

mëvetësinë e shpalosjes së formave të njohjes me pikëshikime që nuk i hasim në fusha të tjera të dijes. Komunikimi me këto vepra nxiste soditje dhe refleksione. Do ta përmendja një shembull tjetër të mëvetësisë së të menduarit filozofik. E kam fjalën për pyetjen të cilën Heideggeri e quan si pyetje e parë filozofike, që ai e gjen brenda filozofisë klasike gjermane, te Leibnizi: “Përse, pra, ka qenie e jo më parë asgjë?” Termi “qenie” emërton gjithçka që është, tërësinë e gjithë asaj që është. Kjo pyetje nuk ka karakter pragmatik ngaqë prej saj nuk mund të nxjerrim ndonjë dobi por, siç vë në pah Heideggeri, njeriu e realizon *dinjitetin* e vet si qenie mendore duke e shtruar këtë pyetje meqë ajo na shpie te pyetja burimore filozofike e *kuptimit të qenjesimit* të qenies. Me termin “Seiende” Heideggeri emërton gjithë atë që është, jo vetëm gjësendet, por edhe përfytyrimet tona, të gjithat për çka ne flasim nga e tashmja ose nga e kaluara. Ndërkaq me “Sein”, si folje e substantivuar, Heideggeri emërton *mënyrën si është ajo që është*, procesualitetin e asaj që është brenda dimensionit kohor. Këtë term e kam përkthyer në shkrimet e mia me termin “Qenjësimi”. Më vonë, në shekullin XVII,

filozofi dhe shkrimtari francez Blaise Pascal e shpreh këtë ide, më thjesht, me thënien se “njeriu është vetëm një kallam, më i dobëti i natyrës, por ai është kallam që mendon”. Më kujtohet se, disa vite më vonë, kur nisa të punoj në Degën e Filozofisë në Prishtinë, pranë Fakultetit Filozofik, përgatita disa tekste filozofike për t’i shqyrtuar me studentët e mi. Nëpunësit që më ndihmonte rreth printimit të tyre i kishte rënë në sy kjo fjalë e Pascalit: “Sa i bukur e i thellë ky mendim qenka” më tha. Dua të theksoj se, krahas studimeve në filozofi, në Fakultetin Filozofik të Zagrebit, studioja edhe letërsinë franceze. Kjo i përgjigjej nevojës që kisha për ta mbajtur lidhjen edhe me letërsinë, me tekste letrare që shpalosin, me ligjërimin dhe imagjinaren artistike, “botë” të tjera.

*Përse ishte e rëndësishme për ju Shkolla Filozofike e Zagrebit?*

**KULLASHI:** Kjo shkollë ishte e rëndësishme për mua ngaqë më ofroi mundësinë që nga viti i parë i studimeve e deri te doktorata, por edhe më vonë, ta shijoj begatinë e jetës filozofike që zhvillohej aty përmes ligjëratave e debateve, si dhe simpoziumeve ku merrnin pjesë, veç filozofëve të Zagrebit, edhe filozofë të çmuar nga Evropa dhe ShBA-ja.

Simpoziumet që organizoheshin jo vetëm në Zagreb, por edhe në ishullin e bukur Korçula, me një ambient arkitektonik që ta kujton agorën e universit të filozofisë greke. Qoftë në Zagreb, qoftë në Shkollën Verore të Korçulës, gjatë shumë viteve kemi pasur mundësinë t’i përcjellim ligjëratat dhe debatet e filozofëve zagrebas (Gajo Petrovic, Branko Boshnjak, Milan Kangërgera, Danko Grlic etj.) me personalitet më të çmuara të filozofisë evropiane dhe amerikane, që u takonin rrymave të ndryshme të filozofisë bashkëkohore: *f e n o m e n o l o g j i s e*, hermeneutikës, filozofisë së Marksit, hajdegerianizmit dhe filozofisë analitike. Vlen të përmend këtu, veç tjerëve, Herbert Marcusen (ShBA), Ernst Bloch (Tubingen, Gjermani), Alfred Ayer (Oxford), Kostas Axellos (Paris), Umberto Cerroni (Romë), Pierre Naville (Paris), Eugen Fink (Freiburg), David Riesman (Cambridge), Lucien Goldman (Paris), Zygmunt Baumann (Tel Aviv), Jurgen Habermas (Frankfurt), Enco Paci (Milano), Robert Cohen (Boston), Erich Fromm (ShBA), Henri Lefebvre (Paris), Agnes Heller (Budapest), André Gorz (Paris), Norman Birnbaum (Amrehts), Howard Parsons (Bridgeport), Serge Mallet (Paris), Erich Heintel (Vien), Karl-Heinz Volkmann-Schluck

etj. Profesorët tanë, në anën tjetër, ftoheshin rregullisht nga universitetet e Londrës, Romës, Parisit, Berlinit e Frankfurtit, si dhe nga disa universitete të shquara të ShBA-së. Ata botonin artikuj në revistat filozofike dhe libra në shtëpitë botuese të këtyre vendeve. Rrezatimi filozofik i revistave dhe botimeve “Praxis”, në disa gjuhë, si dhe konferencave gjatë njëzet vjetëve (1960-1980), realizohej edhe me *nivelin e lartë teorik*, me *thellësinë e hulumtimeve* në këto botime dhe konferenca. Peshë dhe ndikimi i tyre zgjerohej vazhdimisht edhe me *përzgjedhjen e temave pertinente* për shoqërinë bashkëkohore, në vende të Evropës Lindore dhe në Evropën Perëndimore e në ShBA. Kritika e aspekteve të ndryshme të regjimeve komuniste, krahas afirmimit të dimensionit filozofik të mendimit të Marksit, ishte një nga temat e shpeshta si në botimet e Shkollës Filozofike të Zagrebit, po ashtu edhe në simpoziume. Mu për këtë arsye këta filozofë për vite të tëra iu ekspozuan kritikave dhe kërcënimeve të pushtetit. Megjithatë, krahas kurajës së tyre personale, ata patën edhe një mbështetje të fuqishme ndërkombëtare për t’i zhvilluar aktivitetet e tyre shkencore. Kjo atmosferë kishte një vesk të veçantë në ambientin e

arkitekturës greke në ishullin e bukur Korçula.

*A ju solli në jetë filozofia atë që e keni pritur kur filluat t’i përkushtoheni asaj?*

**KULLASHI:** Do të thosha se ajo më ka sjellë më shumë se ç’kam pritur e shpresuar në fillim. Më duket se vetëm pas hyrjes në horizontin e filozofisë mund të zgjohen nevojat për përsiatje, refleksione e kërkime filozofike. Kur e them këtë e kam parasysh jo vetëm leximin dhe interpretimin e teksteve filozofike e letrare, por edhe të jetuarit që përshkohet me to; këto refleksione e kërkime na ndihmojnë që të ballafaqohemi edhe me situata dramatike historike. Përgjigjen në pyetjen tuaj do ta plotësoja me evokimin e titullit të një libri të bisedave me historianin e shquar bashkëkohor francez Paul Veyne: *Dhe në përjetësi nuk do të mërzitem*. Natyrisht se ka ironi në këtë formulim, meqë Veyne, veç të tjerash edhe si historian, e di fort mirë sa e shkurtër është jeta e një njeriu.

*(Intervistën e plotë mund ta lexoni në numrin e tetë të revistës “Akademia” që sapo ka dalë nga shtypi. Revistën e gjeni në librarinë “Artini”, “Dukagjini” dhe në redaksinë e gazetës “Epoka e re” në Prishtinë. Të drejtën e botimit: “Akademia” dhe shtëpia botuese “Armagedoni”)*



E rrallë

# Vrima që “gëlltiti” 21 vetura

Në provincën kineze Sichuan binte shi për ditë të tëra dhe krijoi dëmtime në infrastrukturë. Një qendër e madhe tregtare u shemb, duke krijuar një vrimë kaq të madhe që thjesht “gëlltiti” njëzet e një automjete dhe dëmi material ishte i madh. Siç është raportuar, nuk ka pasur viktima në njerëz dhe askush nuk është lënduar. E gjithë ngjarja është regjistruar nga kamerat.



FOTO E DITES



Perëndimi i diellit nga plazhi i Ksamilit/ Foto:LSA/ Isaphoto.com

## BARSOLETA E DITËS



Vjen gruaja e nervozuar në shtëpi.  
- Zemër, do ta padis taksistin në gjykatë.  
Sot, në dy raste, për pak sa nuk më mbyti.  
- Mos u ngut zemër. T'i japim edhe një rast.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E jashtëzakonshme

# “Lopët fluturuese” shijojnë teknologjinë e re të transportit

E dhe pse ky rrugëtim është një traditë e vjetër, teknologjitë e reja kanë bërë të mundur kalimin e shpejtë të bagëtive. Javën që shkoi një lopë e lënduar u transportua nga ajri nga shtegu malor Klausen në

Zvicër drejt lëndinave me helikopter. Fermeri Ambros Arnold pohoi për mediat lokale se transportimi i bagëtive të lënduara apo të sëmura në këtë metodë ndihmon që ato t'i ruajnë fuqitë e të shërohen më shpejt.



### DASHI

Mes shoqërisë suaj do të keni një humor të mirë dhe do të arrini të bëni ato gjëra që keni dashur gjithmonë. Fryma e lirë që ju karakterizon, do t'ju bëjë më konstruktiv.



### DEMI

Do të kujdeseni për çdo para që fusni apo nxirrni nga xhepi. Nëse hiqni dorë nga gjërat e zakonshme, ju do të merrni perspektiva më të mëdha.



### BINJAKËT

Ju keni një qiell të hapur për perspektivat e shkëlqyera. Aventurat momentale dhe kënaqësitë për ata që kanë vendosur t'i kalojnë pushimet me njerëz që i njohin.



### GAFORRJA

Njerëzit ju besojnë dhe ndihen të qetë në praninë tuaj. Ju e dini se si t'i vendosni të tjerët në lehtësi pa asnjë përpjekje.



### LUANI

Suksese të mëdha për ata që punojnë në botën e mediave, komunikimit, studimeve, tregtisë dhe bashkëpunimeve me njerëz të huaj. Përgjigjja që prisnit po vjen.



### VIRGJËRËSHA

Një shqetësim delikat dhe disa dyshime mund ta prishin ditën tuaj sot, por nuk keni arsye pse të shqetësoheni.



### PESHORJA

Sfera sentimentale shkëlqen, pavarësisht gjendjes suaj. Yjet ju sugjerojnë që të ecni para dhe të bëni disa ndryshime në jetën tuaj.



### AKREPI

Në këtë verë të bukur ju jeni ndërgjegjësuar që të mos u dorëzoheni polemikave dhe ndërhyrjeve që mund të përballeni dhe në fund të merrni gjithmonë kënaqësinë e merituar.



### SHIGJETARI

Sfera sentimentale ka mbrojtje të mira astrale që stimulojnë kënaqësitë e jetës, dashurinë në veçanti.



### BRICJAPI

Tani më shumë se kurrë është e mençur t'i përbaheni një regjimi shëndetësor të rregullt. Për ta përmirësuar stilin e jetesës suaj, është e nevojshme të mos devijoni nga orari i zakonshëm.



### UJORI

Kjo e premtë është ndriçuar nga yje që flasin për dashuri, kënaqësi për t'i ndarë me ata që i doni, për krijimtarinë dhe artin.



### PESHQIT

Kontrastet e vogla planetare përpiqen të vënë në dyshim hijeshinë dhe kreativitetin tuaj. Do të kapërceni çdo pengesë me ndihmën e mençurisë së dhënë nga Saturni.

## Mozzik dhe Kida, bashkëpunim të ri



**M**ozzik dhe Kida, pas dy bashkëpunimeve të fundit 'PP' dhe 'Kërkun', me postimet e fundit kanë nxitur dyshimet se janë duke punuar në një tjetër projekt. Është këngëtarja ajo e cila në "Instagram" ka shpërn-

darë një imazh ku shihej së bashku me reperin nga Ferizaj në studion e producentit muzikor 'Rzon'. Kida momentalisht është duke punuar në një projekt solo të titulluar "Edhe sa", e cila pritet të publikohet shumë shpejt.

## Angelina Jolie nuk dëshiron që të ndahet nga Brad Pitti



**A**ktorja Angelina Jolie ka kërkuar së fundmi që gjykatësi që merret me çështjen e divorcit me aktorin Brad Pitt të ndërrohet. Sipas mediave të huaja, Angelina Jolie nuk do që divorci të përfundojë. Duke marrë parasysh se ata që lëndohen më shumë nga e gjithë kjo janë fëmijët, burime pranë ish-çiftit thonë se

aktorja është duke bërë një lojë. "Kjo është një lojë që ajo po luan. Është ajo që i ka fëmijët pjesën më të madhe të kohës dhe po përpiqet t'i mbaj sa më gjatë të jetë e mundur". Nga ana tjetër, thuhet se aktorja e ka një raport dashuri-urrejtje për Bradin, një tjetër arsye pse nuk do që ky divorc të përfundojë njëherë e mirë.



## Prestigjiozja greke shkruan për pushimet e Rita Orës

**K**ëngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare, Rita Ora, ka qenë mjaft e përfolur javët e fundit në media. Ajo është fotografuar me trupin e tonifikuar në bikini, gjatë pushimeve në Korfuz me të dashurin e ri, Romain Gavras. Mesa duket origjina e të dashurit të saj të ri, Romain, i cili është greko-francez, e ka bërë këngëtarën që me dëshirë ta vizitojë bregdetin e zgjedhur. Duke qenë se Korfuzi ndodhet në jug të Shqipërisë, çifti duket të jetë fare pranë brigjeve të bregdetit shqiptar. Prania e saj nuk mund t'i shpëtonte edhe vëmendjes së mediave greke. Lajmin për praninë e saj në Korfuz,

"Protothema" e ka renditur si të katërtin më të rëndësishëm në faqe, duke përmendur edhe origjinën e Orës, ku theksojnë se vjen nga Prishtina e shumëvujtur, se gjyshi i saj nga ana e nënës ishte një konsull në Rusi, por pjesa tjetër e familjes, si ajo, ka punuar në punë të ndryshme për të mbijetuar. Nga ana tjetër, kanë kujtuar edhe një deklaratë të të dashurit të Ritës, i cili është shprehur gjatë një dalje televizive: "Kur isha fëmijë babai im më tregonte histori para se të shkoja të flija për kapitenët me mjekër, për Greqinë e varfër, duke pasur një aversion patologjik ndaj britanikëve dhe konkretisht ndaj Churchillit".

## Aktorja e 'Harry Potter'-it bëhet nënë

Aktorja 29-vjeçare, të cilën e kemi parë në tri seri të "Harry Potter"-it, është bërë nënë. "Këtë pasdite Scarlett dhe unë mirëpritëm vajzën tonë Betsy Rose Hefner. Jemi të emocionuar dhe falënderues, plot dashuri dhe kënaqësi", ka shkruar Cooper në llogarinë e vet në "Instagram", shoqëruar nga një fotografi e fëmijës së porsalindur. Cooper dhe Scarlett janë së bashku për më shumë se gjashtë vjet dhe u fejuan në vitin 2015. Cooper është djali i ish-pronarit të revistës së famshme "Playboy", Hugh Hefner.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Ademi: Vendimi i Gjykatës Supreme vërteton pafajësinë time

Gjykata Supreme rastin e kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, e ka kthyer në rigjykim. Numri një i FFK-së ka thënë se ky vendim e ka vërtetuar pafajësinë e tij. “Me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës u konfirmua pafajësia ime në lidhje me pretendimet e pabazuara të Prokurorisë së Republikës së Kosovës”, ka thënë Ademi



**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 25 GUSHT** - Gjykata Supreme e ka kthyer në rigjykim rastin e kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi. Ky i fundit ishte dënuar me nëntë muaj burgim nga Gjykata Themelore e Prishtinës në vitin 2019 për veprën penale detyrim në tentativë. “Kolegji i Gjykatës Supreme, në çështjen penale të të dënuarve A. A. dhe M. R., për shkak të veprës penale detyrim në tentativë, ka aprovuar si të bazuara kërkesat e tyre për mbrojtje të ligjshmërisë dhe çështjen e ka kthyer për rigjykim, në shkallë të parë”, thuhet në njoftimin e Gjykatës Supreme. “Aprovohen si të bazuara kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit M. R. dhe ajo e të dënuarit A. A., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR. nr.

51/2014 datë 5 korrik 2019 dhe ai i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR. nr. 504/2019 datë 12 shkurt 2020 anulohen, kurse çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim”, thuhet në njoftimin e Gjykatës Supreme. Pas këtij vendimi ka reaguar edhe kryetari i FFK-së, Agim Ademi, i cili ka thënë se me vendimin e kthyer në rigjykim nga Gjykata Supreme, vërtetohet pafajësia e tij. “Me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës u konfirmua pafajësia ime në lidhje me pretendimet e pabazuara të Prokurorisë së Republikës së Kosovës. Me këtë aktgjykim u konfirmuan shkeljet e shumta në të cilat ishin përfshirë Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Gjykata e Apelit të Kosovës, të cilat padrejtësisht më shpallën fajtor në lidhje me veprën penale që pretendohej nga prokuroria. Që nga fillimi i këtij procesi penal kam qenë i bindur në pafajësinë time dhe besimin në drejtësi, të cilën e

vërtetoi edhe Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me kthimin e çështjes në rivendosje. Besimi im në organet e drejtësisë së Republikës së Kosovës nuk ka munguar asnjëherë, ashtu që ky besim më është shtuar pas këtij vendimi të drejtë dhe të ligjshëm për të cilin u njoftova sot (e martë)”, ka thënë Ademi. Numri një i Federatës së Futbollit të Kosovës më pas ka falënderuar të gjithë ata që besuan në pafajësinë e tij. “Falënderoj për besimin dhe përkrahjen e vazhdueshme të Federatës së Futbollit të Kosovës, organeve të saj, bashkëpunëtorëve të mi, avokatin e Federatës së Futbollit të Kosovës, si dhe avokatët e mi, të cilët bashkërisht kanë kontribuar për marrjen e një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm. Ju falënderoj të gjithëve për interesimin, mesazhet dhe urimet e shumta. Ecim tutje me krenari e përgjegjësi drejt sukseseve të reja”, ka shtuar Ademi.

## SHKURT

### Shtyhet Kupa Evropiane në hendboll

Ndeshjet e Kupës Evropiane në hendboll për meshkuj, në të cilën garë do të paraqiten dy skuadra, janë shtyrë. Njoftimi ka ardhur nga Federata Evropiane e Hendbollit, bën të ditur Federata e Hendbollit të Kosovës në faqen zyrtare. “Ndeshjet e raundit të dytë dhe tretë të kësaj gare janë shtyrë për një muaj. Kështu, ndeshjet e raundit të dytë, që është dashur të luhen në tetor, do të luhen në nëntor. Ndërsa ndeshjet e raundit të tretë, që është dashur të luhen në nëntor, janë shtyrë për në dhjetor”, thuhet në njoftimin e FHK-së. Kurse sipas EHF-së, është vendosur kështu për t'u dhënë pjesëmarrësve më shumë kohë për t'u përgatitur, me shpresë se situata e përgjithshme me koronavirus do të përmirësohet.

### Shtyhet afati për paraqitjen e klubeve dhe afati kalimtar për basketbollistë

Pas marrjes së vendimit nga Bordi i FBK-së për shtyrje të fillimit të edicionit të ri të garave në basketboll, Bordi ka vendosur për shtyrjen e afatit për paraqitjen e klubeve dhe afatin kalimtar për basketbollistë vendorë dhe të huaj. Afati për paraqitjen e klubeve do të jetë deri më 10 shtator në orën 14:00, ndërkohë afati kalimtar për basketbollistë/e të jetë deri më 28 shtator në orën 14:00. Ndërkohë, afati i fundit për dorëzimin e Rosterit final është deri më 29 shtator, po ashtu në orën 14:00.

### Katër klube italiane në garë për Vojvodën

Mbrojtësi i Standardit dhe Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Mërgim Vojvoda, është në shënjestër e disa klubeve italiane. Pas Fiorentinës, Lazios dhe Atalantës, garës për mbrojtësin e djathtë i ka hyrë edhe Torino. 25-vjeçari ka kontratë me skuadrën belge deri në vitin 2023, por me gjasë ai në edicionin e ri do të luajë në Serinë A.

### Largimi i Thaqit nga Prishtina, i mundur

Kapiteni i Prishtinës, Armend Thaqi, është afër largimit nga klubi më i madh në vend. Mbrojtësi i djathtë nuk ka vazhduar ende kontratën me bardhekaltrit dhe divorci pritet të ndodhë në ditët në vijim. Thaqi ishte lojtari më i dalluar te Prishtina në dy vjetët e fundit. “Nuk e kam vazhduar ende kontratën me Prishtinën, ndërsa sa i përket të ardhmes, ende nuk ka diçka konkrete”, ka thënë Thaqi për “Olle”.

### Superkupa e Evropës do të luhet me tifozë

UEFA ka njoftuar zyrtarisht se tifozët do të lejohen në stadium për finalen e Superkupës Evropiane mes Bayern Munchenit dhe Sevilas. Tifozët do të rikthehen në stadium më 24 shtator kur luhet dhe finalja në Budapest mes fitueses së Ligës së Kampionëve dhe fitueses së Ligës së Evropës. “Komiteti ekzekutiv i UEFA-s ka vendosur se do të lejojë që finalja e Superkupës së Evropës të luhet me një numër të reduktuar tifozësh, deri në 30 % të kapacitetit të stadiumit. Të gjitha ndeshjet e tjera të kompeticioneve të UEFA-s do të vazhdojnë të luhen pa tifozë deri në një njoftim të dytë”, thuhet në njoftimin e UEFA-s.



## Futbollisti serb i APOEL-it nuk pranon të luajë në Kosovë

PRISHTINË, 25 GUSHT - Të enjten në stadiumin 'Fadil Vokrri' nënkampioni i Kosovës në futboll, Gjilani, do të përballet me skuadrën qipriote, APOEL Nicosia, në kuadër të fazës së parë kualifikuese të Ligës së

Evropës. Por futbollisti i skuadrës udhëtuese, serbi Vujadin Saviq, ka refuzuar të luajë ndaj ekipit nga Gjilani. "Arsyeja e parë është se unë u karantinova për 24 ditë për shkak të 'Koronës' dhe nuk jam

akoma 100 për qind fizikisht i gatshëm. Arsyeja e dytë i përket udhëtimit dhe ndeshjes me klubin nga i ashtuquajtimi shtet i Kosovës. Është e qartë për ju që nuk ka asnjë shans që ata të më shtynin të udhëto-

ja atje dhe të luaja një lojë kundër tyre. Kjo do të thoshte automatikisht që e pranoj atë dhe në njëfarë mënyre ta mbështes atë histori artificiale. Kjo nuk vjen në shprehje", ka thënë ai për "telegraf.rs".



## Nga basketbolli në muzikë, pasionet e Pjetër Dodës

PRISHTINË, 25 GUSHT - Pjetër Doda ka vendosur gjithmonë t'i ndjekë ëndrrat e veta. Pasionin për sportin dhe muzikën. Doda është marrë me basketboll për nëntë vjet, kurse tani merret me muzikë, duke ndjekur ëndrrën e kamotshme. Nga sporti me duar, te muzika me zë, Pjetër Doda rrëfëhet në një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së. "Në basketboll kam qenë aktiv për nëntë vjet. Nga viti 1999 deri më 2008 kam qenë pjesë e Bashkimit të Prizrenit dhe më 2011-2012 pjesë e Kolegjit Universi të Prishtinës", ka treguar ai. Muzika ishte pasioni i parë i tij. "Muzika ka qenë pasioni im i parë dhe ëndërr qysh në fëmijëri, gjë të cilën e kam praktikuar shumë herë në të kaluarën", shprehet Doda për faqen zyrtare të FBK-së. Ai ka vendosur ta ndjekë ëndrrën e



vet në muzikë. "Përfundimisht kam vendosur ta vazhdoj karrierën time si këngëtar, ku para disa ditëve kam debutuar dhe lansuar këngën/projektin e parë 'Më gënje', e cila është një baladë shumë e bukur e prodhuar nga Bekim Hallaqi dhe 'Belle Records'", ka shtuar

Doda. Doda tashmë tregon edhe planet për të ardhmen. "Kënga është pritur mjaft mirë nga të gjithë, ndërsa tani jam duke punuar në tre projekte të reja, të cilët pritet të lansohen shumë shpejt", është shprehur Doda.

## Le Broni shkëlqen në fitoren e Lakersave kundër Portlandit

ORLANDO, 25 GUSHT - Los Angeles Lakersi dhe Milwaukee Bucks janë vetëm një fitore larg kalimit në fazën tjetër të "play-off"-it në NBA. Kalifornianët dhe skuadra Winconsi fituan edhe përballet e 4-ta ndaj Portland Trail Blazersit dhe Orlando Magicut me shifrat 135-115 dhe 121-106 dhe tashmë kryesojnë seritë në Perëndim dhe në Lindje 3-1 me ndeshje. Mbreti James me 30 pikë, 6 rebounde dhe 10 asistime dhe i përhershmi Giannis Antetokounmpo me 31 pikë, 15 rebounde dhe 8 asistime ishin ata që udhëhoqën Lakersat dhe Bucksin drejt fitoreve të radhës. U kualifikua në gjysmëfinalet e Lindjes, Miami Heat, që fitoi edhe sfidën e 4-të ndaj Indiana Pacersit me rezultatin 99-87. Ndërkohë barazoi 2-2 serinë Oklahoma City Thunderi që fitoi edhe ndeshjen e 4-të me rezultatin e ngushtë 117-114 për meritë të dyshes së zakonshme Denis Schorder-Chris Paul.



### SHKURT

#### 2 847 teste për Covid-19, vetëm një pozitiv në Formula 1

"FIA dhe Formula 1 konfirmojnë se nga data 14 deri më 20 gusht janë kryer 2 847 teste për Covid-19 te pilotët, skuadrat dhe personeli. Nga këto teste, vetëm një person ka rezultuar pozitiv", thuhet në komunikatën e FIA-s. Ky është numri më i vogël i testeve të kryera nga FIA gjatë këtyre ditëve krahasuar me javët e mëparshme për shkak se nuk ka pasur garë fundjavën e shkuar. FIA dhe Formula 1 nuk kanë bërë me dije emrin e personit që ka dalë pozitiv dhe kanë deklaruar se këtë gjë do ta bëjnë edhe javët në vijim. "Nuk do të japim asnjë detaj specifik në lidhje me skuadrat apo individët që do të rezultojnë pozitivë me koronavirus gjatë testeve që kryejmë. Rezultatet do të bëhen publike çdo 7 ditë", thuhet në komunikatë.

#### Klinsmann: Bale duhet të rikthehet në Tottenham

Ish-sulmuesi i Tottenhamit, Jurgen Klinsmann, i ka bërë thirrje Gareth Bale që të kthehet te "Gjelat" e Londrës. Sulmuesi i Real Madridit nuk ka një marrëdhënie të mirë me trajnerin Zidane dhe ka bërë me dije se është gati t'i kalojë dy vjetet e fundit të kontratës që ka me mardrilenët edhe pa luajtur. "Qëndrimi në stol është ndëshkimi më i keq për një lojtar. Gjëja më e rëndësishme për çdo futbollist është të jetë në fushën e lojës. Kur kjo nuk ndodh, atëherë duhet të mendosh për t'u larguar. Si tifoz i Tottenhamit do të doja që ai të kthehej. Ne do ta adhuronim një lojtar si ai javë pas javë në televizor", ka thënë Klinsmann.

#### PSG-ja në garë për Suarezin

Paris Saint Germaini po synon transferimin e Luis Suarezit, i cili duket se nuk bën pjesë në planet e Barcelonës për edicionin e ri. PSG-ja dhe Barcelona nuk kanë aspak një raport të mirë mes tyre që nga transferimi i Neymarit për 222 milionë euro, por zgjidhje mund të jetë zgjedhja e kontratës nga vetë futbollisti. Një tjetër opsion për Suarezin ishte një rikthim i mundshëm tek Ajax, por agjenti i tij ka mohuar një transferim të tillë. Suarezi përfiton 300 mijë euro në javë, një shifër që mund të përballohet vetëm nga PSG-ja.

#### Sterlingu rezulton negativ në testin për koronavirus

Raheem Sterling ka dalë negativ pasi mori pjesë në ndeshjen e Usain Boltit në Xhamajkë të premtën, raporton "Sky Sports News". Tetë herë fituesi i medaljes së artë olimpikë ka ngjallur frikë pasi ka hyrë në vetizolim derisa ishte në pritje të testit të tij. Mirëpo, Sterling ka dalë negativ pas testimit në Xhamajka dhe shpreson të ftohet në ekipin e Anglisë për ndeshjet e muajit të ardhshëm në Ligën e Kombeve.

#### Veseli lë Francën, rikthehet në Itali

Aventura në Francë te Le Mans zgjati shumë pak për Frederik Veselin i cili, për shkak të pandemisë Covid-19, nuk luan që prej muajit mars kur u ndërpre sezoni futbollistik në Francë. Në sezonin e ri, mbrojtësi i kombëtares shqiptare do të ndërrojë sërish skuadër pasi ka firmosur deri në vitin 2022 për Salernitanën. Veseli largohet kështu përfundimisht nga Empoli me të cilin kishte edhe një vit kontratë për t'u transferuar te skuadra e Fabrizio Castorit që në sezonin e fundit të Serisë B, u rendit në vendin e 10-të duke mos mundur dot të kualifikohet në "play-off". Më 1 shtator kur hapet edhe merkato, Veseli do të bashkohet me skuadrën e re. Një përvojë e re në Itali për 27-vjeçarën kuqezin i cili synon ta rifitojë formën optimale për t'u grumbulluar rregullisht edhe në kombëtaren shqiptare.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government  
Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës



Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik - Shtime  
The Centre for integration and rehabilitation of chronic psychiatric patients - Shtime  
Centar za integrisanje i rehabilitaciju hroničnih psihijatrijskih bolesnika - Shtimlje

#### Sektori i Personelit

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik; nenit 6 parag. 1.1, nenit 10 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK); nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi; kërkesës nr.307 si dhe aprovimit të kërkesës me Nr 1570 nga UD Drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-se; Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik - Shtime, publikon:

### K O N K U R S P U B L I K

**I. Institucioni:** Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik dhe Psikiatrik-Shtime

**Pozita punës:** Ndhimës mjekësor (dy pozita)

**Koeficienti i pagës:** 5

**Orari i punës:** I plotë

**Kohëzgjatja e kontratës:** Kohë të pacaktuar

**Nr. i Referencës:** QIRSKP- 01/2020

#### Qëllimi kryesor i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore duke u bazuar në nivelin profesional që kërkohet për të gjithë profesionistët shëndetësor.

#### Përshkrimi i punëve dhe fushat e përgjegjësisë për ndihmës mjekësor :

- Përgatitja e pacientëve për mëngjes me nivel të lartë të higjienës personale
- Qëndrimi në kuzhinë në mëngjes, drek dhe darkë deri sa ushqehen klientët
- Dërgimi i ushqimit me tase në repart për klientët që nuk ushqehen në kuzhinë ( pasi të ketë mbaruar ushqimi për klientët tjerë që ushqehen në kuzhinë)
- Higjiena personale, pastrimi i klientëve, kujdesi për veshmbathjen, rregullimi i depos së veshmathjeve
- Dërgimi dhe marrja e rrobave nga rrobalarje
- Për çdo ndryshim të gjendjes shëndetësore të klientit, lajmërohet infermieri i repartit
- Përgatitja e klientëve për gjumë nate (pastrimi i këmbëve- higjiena personale në nivel)
- Gjate gjithë ndërrimit të natës pacientet duhet të jenë nën mbikqyerje të vazhdueshme të ndihmësit mjekësor
- Për të gjitha punët dhe shërbimet e kryera ndihmësi mjekësor obligohet të mbajë shënime në fletore të raportit të kujdestareve.
- Ndihmesat mjekësor raportojnë të infermierit
- Të kryejë edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitet të lartë në punë.

#### I. Dokumentet e kërkuara – fotokopje :

- Diploma e Shkollës së Mesme
- Dëshmi se nuk është nën hetime
- Certifikata nga libri amzë i të lindurve,
- Letërnjoftimi – fotokopje,
- Njohja e kompjuterit (Word dhe Excel) – e dëshirueshme,
- Mund të sillni edhe dëshmi tjera të aftësisë profesionale.

#### Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.

Originalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuarat të noteri do të kërkohet vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.

- Përvoja e punës do të ketë përparësi.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave sipas këtij konkursi.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Në testim do të ftohen vetëm kandidatët që kanë plotësuar kriteret e konkursit. Kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit do të nënshtrohen testit me shkrim, dhe të gjithë kandidatët të cilët nuk e kalojnë testin me shkrim mbi 50% do të diskualifikohen automatikisht. Ndërsa të gjithë kandidatët që ju kanë nënshtuar testit me shkrim, dhe kanë arritur të kalojnë atë 50% e më shumë të pikëve të tij, do të ftohen në intervistën me gojë, pranë komisionit përzgjedhës. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas pikëve të përgjithshme që do të fitojë çdo kandidatë nga dy proceset si më sipër (testimi me shkrim dhe intervista me gojë).

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit në QIRSKP-Shtime. Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Shtime, dt.25.08.2020

Drejtori i QIRSKP-Shtime

Dr.Miftar Zenelaj

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » ALFA SOLUTION « SH.P.K., me seli në PRIZREN, WILLIAM WALKER, P.N., ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB. dhe NRF. 811300706 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

## O B A V E Š T E N J E

Obavještavamo sve kliente da društvo » ALFA SOLUTION « D.o.o., sa sedištem u PRIZREN, WILLIAM WALKER, P.N. doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 811300706 putem dobrovolne likvidacije i ujedno imenovao likvidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likvidacije.

Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u roku od 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likvidacije u novini.

## A N N O U N C E M E N T

We inform all clients that the company » ALFA SOLUTION « L.L.C., based in PRIZREN, WILLIAM WALKER, P.N., has taken the decision to cancel the company with Busines and Fiscal No. 811300706 and with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » INFO BEST « SH.P.K., me seli në PRIZREN, EDIT DURHAM, NR:167., ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB. dhe NRF. 811300699 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

## O B A V E Š T E N J E

Obavještavamo sve kliente da društvo » INFO BEST « D.o.o., sa sedištem u PRIZREN, EDIT DURHAM, NR:167 doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 811300699 putem dobrovolne likvidacije i ujedno imenovao likvidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likvidacije.

Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u roku od 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likvidacije u novini.

## A N N O U N C E M E N T

We inform all clients that the company » INFO BEST « L.L.C., based in PRIZREN, EDIT DURHAM, NR:167 has taken the decision to cancel the company with Busines and Fiscal No. 811300699 and with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragas/Dragas Municipality  
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Më: 25.08.2020  
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

#### KONKURS-plotësues

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020/2021.

#### SHFMU "Imi Bahtjari" Blaç

1. Një mësimdhënës për mësim klasor (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

#### SHFMU "Samidin Emini" Kuk

1. Një mësimdhënës për mësim klasor

#### SHFMU "Restelica"

1. Dy mësimdhënës për mësim klasor

#### I. Aplikacioni i bashkëngjiten këto dokumente:

- > Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.);
  - > Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
  - > Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj;
  - > Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar;
  - > Certifikata që nuk jeni nën hetime;
  - > Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
- Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2020, por në varësi të lirimit real të vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në shtet dhe informimit.

**Vërejtje:** Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë: 25.08.2020  
Dragash



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania N.T.SH. "Florenti Trans" Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për prodhimin e betonit në Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 21.09.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorantit Ura e Gurit ( Magjistrale Prishtinë - Mitrovicë) në Maxhunaj komuna e Vushtrrisë, do të organizohet debat publik nga kompania N.T.SH. "Florenti Trans" Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për prodhimin e betonit në Vushtrri.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: 1YsD3f

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

## NJOFTIM PËR SHUARJE TË BIZNESIT

Njoftojmë te gjithë klientët se "Ultra Computing Solutions and services – Prishtina" me seli ne Prishtine, ka marre vendim te shuaje biznesin me numër: NUI. 810001264 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës se Likuidimit.

Njoftohen te gjithë klientët qe kane raporte kreditore- debitorë qe te paraqiten ne afatin kohor pre 30 ditor nga data e shpalljes ne gazete.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

► Hysen Çoçaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit X, XI, XII, XIII dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Ertan Vezaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl V - IX shf "Naim Frasheri" Vlashnje.

► Asllan Vezaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl V - IX shf "Naim Frasheri" Vlashnje.

► Sabuhi Nebiu shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Lirim Nebiu shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Nr-4/11-39890  
Datë: 25.08.2020

Në mbështetje të nenit 35 pika 1 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar Nr. 04/L-032, nenit 5 pika d të Ligjit për Arsim në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, nenit 18 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ 15/2019 të MASHT, Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan, rishpall:

**KONKURS**  
Për plotësimin e vendeve të punës

- Drejtor në SHFMU "E. Koliqi" në Babush i M
- Drejtor në SHFMU "Migjeni" në Rufe i Ri
- Drejtor në SHFMU "Fehmi Agani" në Medvec

**Kandidatët e interesuar për pozitën e drejtorit duhet ti plotësojnë këto kushte:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimi prej 330 ECTS, me së paku pesë (5) vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor, kualifikimi 300 ECTS, 5 vite të shkollimit universitar – Fakulteti katër vjeçar (4) me 240 ECTS, katër (4) vite të shkollimit universitar, të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas UA për licencimin e mësimdhënësve;
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim të aprovuar nga MASHT sipas rekomandimit të KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;
- Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në SHFMU;
- Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë.

**Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të plotësojnë këto dokumente:**

1. Kërkesën;
2. Certifikata e lindjes;
3. Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
4. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
5. Dëshmi se nuk është nën hetime dhe dëshmia se nuk ka qenë i/e dënuar për krim dhune ose vepra të pa denja që përfshijnë fëmijët;
6. Dëshmi për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
7. Koncepti i planin zhvillimor të institucionit edukativo - arsimor dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar, koncepti duhet të bazohet në fushat e cilësisë së paku 10 faqe tekst (një faqe për një fushë) me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12 Arial, koncepti dorëzohet si pjesë e portofolios, por është edhe pjesë kryesore e intervistës;
8. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuere për punën dhe angazhimin paraprak nga institucion publik kredibil (MASHT, DKA, Këshilli i Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe për arsim);
9. Letër motivuese për vendin e punës për të cilin aplikon;
10. Portofolion profesionale (shih shtojcën G);
11. Kandidati/ja për drejtor dhe zv. drejtor nuk mund të jetë në funksion udhëheqës politik gjatë tri viteve para aplikimit.

**Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit:**

- Drejtori i institucionit edukativo-arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit duke përfshirë:
  - Përgatitjen e planit vjetor të punës, panit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
  - Përdorimi efikas dhe efektiv të sistemeve informative për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës, sigurimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë tërë vitit shkollor;
  - Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin e mësimdhënësve, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe kuadrin tjetër arsimor;
  - Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
  - Bashkëpunon me Këshillin Drejtues të shkollës, Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve edhe Këshillin e Nxënësve;
  - Raporton dy herë në vit para Këshillit të shkollës;
  - Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit, duke përfshirë edhe masat disiplinore ndaj nxënësve;
  - Bënë ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga Komuna apo MASHT;
  - Çështjet tjera që rregullohen përmes ligjit dhe obligimet që dalin nga Rregullorja e Komunës për arsimin sipas niveleve përkatëse në arsim;
  - Vlerësimi i performancës së drejtorëve do të bëhet UA përkatës bazuar në standardet e praktikës profesionale të drejtorëve;
- Kohëzgjatja e kontratës së punës:** Periudha kohore e kontratës zgjat katër (4) vite, Kandidatëve të zgjedhur për drejtor mund tu vazhdohet kontrata në të njëjtin institucion pa konkurs publik në bazë të rezultateve të vlerësimit të performancës që është i rregulluar me akt të veçantë nënligjor, bazuar në Ligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.
- Aplikacionet merren në ndërtesën e KK në Lipjan, në Qendrën për shërbime të qytetarëve sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtin vend,
- Kërkesat e pakompletuara dhe të arritura pas afatit refuzohen, nuk shqyrtohen,
- Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet ligjore.
- Afati i konkursit është 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor, ueb faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve të Komunës.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

